



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



RAPORT VJETOR

Gjendja e Sektorit te Energjise dhe Veprimtaria e ERE-s gjate Vitit 2009

Permbajtja e lendes

- Treguesi i figuravefaqe 4
- Treguesi i tabelavefaqe 6
- Hyrjefaqe 7
- **Funksioni rregullator dhe struktura e funksionimit te ERE-s.....faqe 8**

Pjesa e Pare

I- Rregullimi ne tregun e energjise elektrike

1. Tregu i energjise elektrike.....faqe 10
2. Prodhimi i energjise elektrike.....faqe 11
 - 2.1. Prodhimi publik i energjise elektrike.....faqe 11
 - 2.2. Prodhimi privat i energjise elektrike.....faqe 15
 - 2.3. Eficienca e prodhimit te energjise elektrike.....faqe 20
3. **Konsumi i energjise elektrike.....faqe 22**
 - 3.1. Kerkesa per energji elektrike.....faqe 23
 - 3.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike.....faqe 24
 - 3.3. Profili i konsumit te energjise elektrike.....faqe 28
 - 3.4. Importi i energjise elektrike.....faqe 30
 - 3.5. Eficienca e konsumit te energjise elektrike.....faqe 33
4. **Operatori i Sistemit te Transmetimit.....faqe 37**
 - 4.1. Struktura e Operatorit te Sistemit te Transmetimit.....faqe 38
 - 4.2. Zhvillimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit.....faqe 38
5. **Operatori i Sistemit te Shperndarjes.....faqe 39**
 - 5.1. Struktura e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes.....faqe 40
6. **Privatizimi i Operatorit te Shperndarjes**
 - 6.1. Zhvillimi i procesit te privatizimit.....faqe 41
 - 6.2. Deklarata Rregullatore.....faqe 42
 - 6.3. Garancia e riskut rregullator.....faqe 43
7. **Siguria e furnizimit me energji elektrike.....faqe 44**

Pjesa e Dyte

II- Rregullimi ne tregun e gazit natyror

- 1.1. Analiza e sektorit te gazit natyror ne Shqiperi, viti 2009.....faqe 46
- 1.2. Zhvillimete ne sektorine gazit natyrorne BE dhe rajonin Ballkanik dhe implikimet per vendin tone.....faqe 47
- 1.3. Arritjet e ERE-s ne sektorin e gazit natyror gjate vitit 2009 Dhe sfidat per te arthmen.....faqe 50

Pjesa e Trete

III- Veprimtaria e Entit Rregullator te Energjise

1. **Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike per vitin 2010.....faqe 52**
 - 1.1. Metodologjite dhe procedurat e percaktimit te cmimeve e tarifave.....faqe 52

1.1.1	Tarifa e energjise elektrike per gjenerimin publik.....	faqe 53
1.1.2	Tarifa e energjise elektrike per Furnizuesin Publik me Shumice..	faqe 53
1.1.3	Cmimi i energjise elektrike per HEC-et egzistues deri 10 MW.....	faqe 54
1.1.4	Cmimi i energjise elektrike per HEC-et e rinj deri 15MW.....	faqe 54
1.1.5	Tarifa e sherbimit te transmetimit te energjise elektrike.....	faqe 55
1.1.6	Tarifa e sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike dhe e Furnizuesit Publik me pakice.....	faqe 56
1.2.	Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike ne tregun rajonal, viti 2009.....	faqe 60
1.3.	Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike ne tregun e BE-se, viti 2009.....	faqe 61
2.	Licensimi i veprimtarive ne Tregun e Energjise Elektrike..	faqe 63
2.1.	Licensimi per prodhimin e energjise elektrike.....	faqe 64
2.2.	Licensimi per tregtimin e energjise elektrike.....	faqe 65
2.3.	Certifikimi i energjive te rinovueshme.....	faqe 66
3.	Monitorimi ne Tregun e Energjise Elektrike.....	faqe 67
3.1.	Parimet e monitorimit te tregut	faqe 67
3.2.	Monitorimi i KESH-Gjenerimit.....	faqe 68
3.3.	Monitorimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit.....	faqe 68
3.4.	Monitorimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes.....	faqe 69
4.	Veprimtaria e ERE-s per hartimin dhe perpunimin e legjislacionit sekondar.....	faqe 70
4.1.	Aktet nenligjore te miratuara nga ERE gjate vitit 2009.....	faqe 70
4.2.	Amendimet ne legjislacionin primar ne sektorin e energjise gjate vitit 2009.....	faqe 75
4.3.	Aktet e Keshillit te Ministrave per Energjine gjate vitit 2009.....	faqe 76
4.4.	Plotesimi i pyetsorit per energjine, ne proceduren e aplikimit te Shqiperise “Vend Kandidat ne BE”.....	faqe 77
5.	Mbrojtja e konsumatorit nga efekti monopol ne tregun e energjise elektrike.	
5.1.	Parimet e mbrojtjes se konsumatorit.....	faqe 79
5.2.	Trajtimi i ankesave te konsumatoreve gjate vitit 2009.....	faqe 80
5.3.	Trajtimi i procedurave gjyqesore.....	faqe 81
6.	Mardheniet me publikun dhe median.	
6.1.	Procedurat e informimit publik.....	faqe 82
6.2.	Mardheniet me mediat e shkruara dhe vizive.....	faqe 83
7.	Mardheniet nderinstitucionale dhe nderkombetare.....	faqe 83
7.1.	Mardheniet nderinstitucionale brenda vendit.....	faqe 83
7.2.	Mardheniet nderkombetare multilaterale.....	faqe 86
7.3.	Mardheniet nderkombetare bilaterale.....	faqe 87
7.4.	Tregu rajonal i energjise elektrike.....	faqe 87
8.	Burimet njerezore te ERE-s.....	faqe 88
8.1.	Struktura organizative dhe menyra e funksionimit te ER-s.....	faqe 88
8.2.	Trajnimi dhe kualifikimi i personelit.....	faqe 89

Pjesa e Katert**IV- Administrimi i burimeve financiare te ERE-s**

- 1.1. Administrimi i burimeve financiare.....faqe 90
- 1.2. Raporti i Auditit te Pavarur Kontabel per veprimtarine
financiare te ERE-s per vitin 2009.....faqe 97

Pjesa e Peste

- V- Perfundime dhe Rekomandime.....faqe 98**

Pjesa e Gjashte**VI-Anekse**

- Aneks-1- Organograma e funksionimit te ERE-s.....faqe 103
- Aneks-2- Sistemi Elektroenergjetik i Republikes se Shqiperise.....faqe 105
- Aneks-3- 10 Zonat e shperndarjes se OSSH-se.....faqe 107
- Aneks-4- Situata elektroenergjetike ditore e vitit 2009.....faqe 109
- Aneks-5- Kumtesat dhe kualifikimet e punonjesve te ERE-s.....faqe 110
- Aneks-6- Vendimet e Bordit te Komisionereve gjate vitit 2009.....faqe.114

Treguesi i Figurave

- Figura 1.1. Struktura e Modelit Shqiptar te Tregut.....faqe 10
- Figura 2.1 Krahasimi i prodhimit te energjise elektrike 2007-2009.....faqe 12
- Figura 2.2. Prodhimi vjetor i HEC-eve te Sistemit Energjetik, 2005-2009.faqe 12
- Figura 2.3. Oret e punes se HEC-eve te Sistemit Energjetik, 2005-2009...faqe 13
- Figura 2.4. Shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskades se Drinit.....faqe 13
- Figura 2.5. Prurjet e ujit ne HEC-ine e Fierzes ne vitin 2009.....faqe 14
- Figura 2.6. Prodhimi energjise elektrike nga HEC-et private ne 2009.....faqe 17
- Figura 2.7 Prodhimi mujor privat i energjise elektrike ne 2009.....faqe 18
- Figura 2.8 Prodhimi privat i energjise elektrike 2004-2009.....faqe 19
- Figura 2.9 Te ardhurat nga shitja e energjise ne sektorin privat.....faqe 19
- Figura 2.10. Cmimi mesatar i shitjes se energjise nga prodhuesit privat
2004-2009..... faqe 20
- Figura 2.11 Treguesit e efciences se prodhimit te energjise elektrike
2002-2009.....faqe 22
- Figura 3.1. Konsumi i pergjithshem i energjise elektrike 1985-2009.....faqe 23
- Figura 3.2.. Krahasimi i konsumit te energjise elektrike 2007-2009.....faqe 24
- Figura 3.3. Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas
Llojit te konsumatoreve, viti.....faqe 24
- Figura 3.4. Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas cmimeve
Viti 2009.....faqe 25
- Figura 3.5. Struktura e numrit te klienteve sipas cmimeve te energjise
elektrike per vitin 2009.....faqe 25
- Figura 3.6. Konsumi familjar ndaj konsumit total ne periudhen

1985-2009.....	faqe 26
Figura 3.7. Struktura e numrit te konsumatoreve sipas niveleve Te konsumit per vitin 2009.....	faqe 27
Figura 3.8. Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas Zonave te OSSH-se, viti 2009.....	faqe 27
Figura 3.9. Profili i ngarkeses se energjise elektrike ne nje dite dimri viti 2009.....	faqe 28
Figura 3.10 Profili i ngarkeses se energjise elektrike ne nje dite vere viti 2009.....	faqe 29
Figura 3.11. Profili i ngarkeses vjetore te energjise elektrike viti 2009.....	faqe 29
Figura 3.12. Krahasimi i importit te energjise elektrike per periudhen 2007-2009.....	faqe 30
Figura 3.13. Prodhimi dhe importi i energjise elektrike gjate 2002-2009....	faqe 31
Figura 3.14. Struktura e importit te energjise elektrike gjate 2002-2009....	faqe 31
Figura 3.15. Cmimi mesatar i importit te energjise elektrike gjate periudhes 2002-2009.....	faqe 32
Figura 3.16. Vlera e importit te energjise elektrike gjate periudhes 2002-2009.....	faqe 32
Figura 3.17 Efektiviteti i konsumit te energjise elektrike sipas Zonave te OSSH-se ne vitin 2009.....	faqe 33
Figura 3.18. Humbjet totale te energjise elektrike gjate periudhes 2002-2009.....	faqe 34
Figura 3.19. Faturim-arketimet e energjise elektrike gjate periudhes 2002-2009.....	faqe 34
Figura 3.20. Struktura e humbjeve sipas zonave te OSSH-se, viti 2009..	faqe 35
Figura 3.21. Struktura e pajisjes me matesa te klienteve sipas zonave te OSSH-se, viti 2009.....	faqe 35
Figura 3.22. Ndalesat e energjise elektrike gjate periudhes 2002-2009....	faqe 36
Figura 3.23. Bilanci i energjise elektrike ne vitin 2009.....	faqe 37
Figura 4.1. Harta e projekteve te gaz-sjellsave “Nabucco” dhe “South Stream”.....	faqe 49
Figura 4.2. Harta e projektit te gaz-sjellsit “TAP”.....	faqe 49
Figura 6.1. Struktura e cmimit te energjise elektrike per konsumatoret familjare, viti 2010.....	faqe 57
Figura 6.2. Struktura e shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2008.....	faqe 59
Figura 6.3. Struktura e shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2010.....	faqe 59
Figura 6.4. Cmimi mesatar i energjise elektrike 2005-2009.....	faqe 60
Figura 6.5. Cmimet e energjise elektrike te konsumatoreve fundore te vendeve te ERRA-s viti 2008.....	faqe 61
Figura 6.6. Cmimet e energjise elektrike te konsumatoreve jo-familjare te vendeve te BE-s viti 2008.....	faqe 62
Figura 6.7. Cmimet e energjise elektrike te konsumatoreve familjare te vendeve te BE-s viti 2008.....	faqe 62

Treguesi i Tabelave

Tabela 2.1. Struktura e centraleve te prodhimit publik te energjise elektrike.....	faqe 11
Tabela 2.2. Struktura e centraleve te prodhimit privat te energjise elektrike.....	faqe 15
Tabela 2.3. Treguesit e efciences se prodhimit te energjise elektrike.....	faqe 21
Tabela 4.1. Struktura e OST-se viti 2009.....	faqe 38
Tabela 4.2. Investimet e OST-se gjate vitit 2009.....	faqe 39
Tabela 5.1. Struktura e OSSH-se gjate vitit 2009.....	faqe 40
Tabela 6.1. Struktura e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2010.....	faqe 58
Tabela 6.2 Struktura e tariave te energjise elektrike ne vendet e BE-se.	faqe 61
Tabela 6.3. Struktura e licensimit per vitin 2009.....	faqe 63
Tabela 6.4. Karakteristikat e te licensuarve per prodhimin e energjise elektrike per vitin 2009.....	faqe 64
Tabela 6.5. Karakteristikat e te licensuarve per tregtim te energjise elektrike per vitin 2009.....	faqe 65
Tabela 6.6. Kualifikimi i prodhuesve te energjise elektrike nga burime te rinovueshme per vitin 2009.....	faqe 66

Hyrje

Enti Regullator i Energjise (ERE) ne zbatim te ligjit nr.9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, date 30.06.2008 “Per sektorin e gazit natyror”, harton kete Raport Vjetor, i cili prezanton dhe analizon gjendjen e sektorit te energjise dhe veprimtarine e ERE-s gjate vitit 2009.

Ky raport i paraqitet per shqyrtim, ne nje seance te posacme, Komisionit te Veprimtarive Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit te Kuvendit te Shqiperise.

Viti 2009 ne sektorin e energjise eshte karakterizuar nga disa tipare te genesishme sikurse eshte furnizimi i plote dhe pa nderprerje me energji elektrike i konsumatoreve, privatizimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH), futja ne pune e TEC-it te Vlores, hartimi nga ERE i cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2010 per seicilen nga strukturat e pjesmaresve te tregut te rregulluar te energjise elektrike si dhe rritja e metejshme e eficiences ne prodhimin publik te energjise elektrike.

Viti 2009 shenon gjithashtu nje vit te sukseseshem ne pjesmarrjen e investimeve private per ndertimin e burimeve te reja gjeneruese nepermjet mbi 150 propozimeve per ndertim HEC-esh dhe 90 kontratash koncensionare per ndertimin e 231 HEC-eve me fuqi nga 1 deri 150 MW seicili.

Nga pikpamja elektroenergjetike viti 2009 vleresohet si nje vit i mbare, gjat te cilit prodhimi ne vend i energjise elektrike arriti nje nivel te kenaqshem prej rreth 5.2 TWh, konsumi arriti nivelin rekord historik prej rreth 6.6 TWh dhe KESH-i realizoi gjithashtu nje eksport energjie elektrike prej 486.4 GWh dhe nje bilanc pozitiv shkembimi me Republiken e Kosoves prej 9.48 GWh.

Raporti eshte organizuar nga pikpamja e permbajtjes ne 6 pjese.

Ne pjesen e pare trajtohen problemet e rregullimit ne sektorin e energjise elektrike. Nepermjet nje informacioni te bollshem te trajtuar kryesisht ne forme grafike paraqitet situata korente ne tregun e energjise elektrike ne Shqiperi por edhe prirjet e zhvillimeve disa vjecare ne kete sektor. Me rendesi eshte te theksohet se raporti nuk eshte konceptuar vetem si nje dokument informues i situates elektroenergjetike, por ai i ben nje analize shkencore kesaj suate dhe dukurive te saj te shumellojeshme duke arritur ne perfundime dhe rekomandime te rendesishme qoft per manaxheret e sektorit por edhe per vendim-marresit ne nivel qeveritar.

Ne pjesen e pare jane trajtuar problemet e prodhimit publik dhe privat te energjise elektrike, konsumi i saje, importi dhe efienca ne te gjitha veprimtarite e tregut te energjise elektrike. Me tej jane prezantuar operatoret e sistemit te transmetimit dhe te shperndarjes si dhe eshte shpeguar permbajtja dhe zhvillimi i procesit te privatizimit te OSSH-se si dhe problemet e sigurise se furnizimit te konsumatoreve me energji elektrike.

Ne pjesen e dyte jane trajtuar problemet e gazit natyror. Nepermjet nje veshtrimi rajonal dhe global te situates nderkombetare ne projektet e furnizimit

dhe diversifikimit me gaz te vendeve te Evropes Jud-lindore dhe te BE-se, raporti eshte teper realist dhe objektiv ne paraqitjen e interesave te vendit tone ne kete kontekst nderkombetar. Nepermjet raportit informohen nivelet e larta vendim-marese te shtetit per situaten konkrete ne furnizimin e Shqiperise me gaz natyror.

Ne raport evidentohet gjithashtu puna e kujdeseshme qe po kryhet ne ERE ne bashkepunim te ngushte me konsulencen e financuar nga USAID-i per hartimin e nje kuadri rregullator ne sektorin e gazit natyror, bashkekohor dhe ne perputhje te plote me legjislacionin e BE-se.

Ne pjesen e trete raporti prezanton dhe analizon punen e ERE-s ne veprimtarite themelore te saje, si per cmimet dhe tarifat, licensimin e veprimtarive te sektorit te energjise elektrike, monitorimin e tregut dhe te licensuarve, veprimtarine juridike dhe te mbrojtjes se konsumatorit, mardhenieve te ERE-s me publikun, me institucionet brenda vendit dhe ne arenen nderkombetare si dhe per burimet njerzore.

Pjesa e katert e raportit i kushtohet administrimit te burimeve financiare te EREs si dhe raportit te nje auditi te pavarur kontabel.

Ne pjesen e peste, ne menyre te permbledhur, jane paraqitur konkluzionet qe ERE ka evidentuar nga analiza nepermjet ketij raporti dhe rekomandimet per nje permiresim te metejshem te punes ne sektorin e energjise.

Se fundi, ne pjesen e gjashte, jane paraqitur 6 anekse me grafike dhe tabela qe i bashkelidhen permbajtjes se raportit.

Raporti eshte hartuar me pjesmarrjen dhe kontributin e te gjitha Drejtorive te ERE-s dhe i eshte nenshtruar nje nje analize te kujdeseshme ne mbledhjen e Bordit te Komisionereve te ERE-s te dates 25 Shkurt 2010 ku me vendimin nr. 16, u be edhe miratimi i tij.

Funksioni rregullator dhe struktura e funksionimit te ERE-s.

Struktura dhe menyra e organizimit dhe funksionimit te Entit Rregullator te Energjise eshte e mbeshtetur ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003, "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9946, date 30.6.2008 "Per Sektorin e Gazit Natyror".

ERE eshte nje person juridik publik, me seli ne Tirane dhe perbehet nga Bordi i Komisionereve me nje Kryetar dhe 4 antare, te cilet kane funksion vendim-marres dhe emerohen nga Kuvendi i Shqiperise. Pervec Bordit eshte edhe personeli teknik i organizuar ne 4 drejtori dhe perkatesisht ne Drejtorine e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut, Drejtorine e Cmimeve dhe Tarifave, Drejtorine Juridike, te Mbrojtjes se Konsumatorit dhe te Mardhenieve me Publikun si dhe Drejtorine e Administrate, Finances dhe Burimeve Njerzore.

Aktualisht ne ERE punojne gjithesej 32 punonjes, nga te cilet 4 jane punonjes ndihmes. I tere personeli teknik gezon statusin e Nepunesit Civil.

Ne Aneks-1- eshte paraqitur bllok-skema e strukture organizative te ERE-s se bashku me numurin perkates te punonjesve.

ERE e ushtron veprimtarine e vet ne perputhje me ligjet “Per Sektorin e Energjise Elektrike” dhe “Per Sektorin e Gazit Natyror” dhe eshte autoriteti i vetem rregullator ne Shqiperi ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.

ERE si nje institucion i pavarur ne sektorin e energjise, ushtron pergjegjesite e veta ne keto drejtime kryesore:

- Ne licensimin e shoqerive qe kryejne veprimtari ne sektorin e energjise elektrike apo te gazit natyror.
- Ne percaktimin e tarifave te shitjes me pakice ose me shumice te energjise elektrike si dhe te tarifave per lidhjen dhe hyrjen ne rrjetet e gazit natyror dhe te hapsirave te depozitimit apo te instalimeve te gazit natyror te lenget.
- Ne mbrojtjen e interesave te konsumatoreve ne sektoret e energjise elektrike dhe te gazit natyror.
- Ne monitorimin dhe kontrollin e kontratave dhe sherbimeve te te licensuarve dhe sigurise se furnizimit ne sektoret e energjise.
- Ne miratimin e kodeve te funksionimit te rrjeteve dhe te matjes si dhe te rregulloreve apo akteve te tjera nenligjore ne sektoret e energjise.
- Ne nxitjen e efciences, konkurences dhe permiresimin e cilesise se sherbimit ne sektoret e energjise.

Burimet e financimit te ERE-s perbehen nga pagesat e regullimit te te licensuarve dhe nga pagesat e licencave ne sektoret e energjise.

ERE paraqet brenda 31 Marsit te cdo viti ne Kuvend, nje raport vjetor per gjendjen ne sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror si dhe te veprimtarive te ERE-s, perfshire veprimtarine financiare dhe auditimin e veprimtarive fiskale te saje.

Pjesa e Pare

I- Rregullimi ne tregun e energjise elektrike.

1. Tregu i energjise elektrike:

Tregu i energjise elektrike ne Shqiperi funksionon ne baze te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike i miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.338, date 09.03.2008. Ky model eshte hartuar ne zbatim te Direktivave te Bashkimit Evropian per energjine elektrike si dhe te kerkesave te Traktatit te Komunitetit te Energjise te vendeve te Evropes Juglindore, per krijimin e Tregut Rajonal te Energjise Elektrike.

Modeli Shqiptar i Tregut eshte konceptuar per te shpene perpara politikat e Qeverise Shqiptare per reformimin e sistemit elektroenergjetik dhe vecanerisht per privatizimin e sektorit te shperndarjes se energjise elektrike ne nje periudhe afatshkurter. Ai ka per qellim gjithashtu te krijojte nje treg te thjesht te rregulluar, transparent dhe te balancuar te energjise elektrike, mbi bazen e kontratave dypaleshe.

Nje parim i rëndesishem i Modelit te Tregut, i cili mbron ne menyre te drejteperdrejte klientet tarifore dhe rrit sigurine e furnizimit te tyre me energji elektrike, eshte parimi i perdorimit te prodhimit te energjise elektrike prej burimeve hidro ne favor te klienteve tarifore. Ky parim eshte specifik per kushtet e Shqiperise, ku mbi 95% e prodhimit vendas te energjise elektrike realizohet nga HEC-et egzistues me kosto shume te ulet.




Figura 1.1.

(Burimi ERE)

Objektiva te tjera te rendesishme qe synon te arrije Modeli i Tregut jane edhe permiresimi i eficiences se energjise si dhe qendrueshmerise financiare te sektorit elektroenergjetik nepermjet sigurimit te nje shkalle te larte informacioni tregu si dhe te nje strukture te qarte per transaksionet e tregut elektroenergjetik.

Ne figuren -1.1.- eshte paraqitur bllok-skema e struktures se tregut te energjise elektrike.

Eshte me vlere te theksohet nje tipar tjetër i rendesishem i Modelit te Tregut sic eshte kerkesa e tije se te gjitha perfitimet e realizuara nga te licensuarit duhet te shkojne ne dobi te klienteve tarifore.

2. Prodhimi i energjise elektrike

Prodhimi i energjise elektrike realizohet nga shoqerite publike dhe nga prodhuesit privat te cilet jane pronare te centralit elektrik si dhe nga prodhuesit privat te cilet e kane marre me koncension nga shteti centralin elektrik.

2.1. Prodhimi publik i energjise elektrike

Prodhimi publik i energjise elektrike kryhet nga Shoqeria Aksionere KESH-gen me 100% te aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqeria "TEC-Vlora" gjithashtu me 100% te aksioneve nga shteti, e cila eshte pjese e holldingut KESH.

Struktura e centraleve elektrike te prodhimit publik eshte paraqitur ne Tabelen -2.1 - ku fuqia e pergjitheshme e instaluar arrin ne 1,531 MW, nga te cilat fuqia e instaluar e HEC-ve eshte 1,433 MW dhe e TEC-eve 98 MW. Duke marre parasysh edhe fuqine e pergjitheshme te instaluar te prodhuesve private te energjise

Karakter. e Centralit	Centrali								
	HEC Fierz	HEC Koman	HEC V.Dejes	HEC Ulez	HEC Shkopet	HEC Bistric 1	HEC Bistric 2	HEC Lana- bregas	TEC Vlore
Nr. Agregat.	4	4	5	4	2	3	1	2	2
Fuqia e Agregat. MW	125	150	50	6.3	12	7.7	5	2.5	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	25	24	24	5	5	98
Fuqia Totale MW	1,531								

Tabela 2.1.

(Burimi KESH sh.a.)

elektrike prej 26 MW, fuqia e pergjitheshme e instaluar ne vendin tone rezulton 1557 MW.

Prodhimi publik i energjise elektrike ne vitin 2009 u realizua krejtesisht

(ne masen 100%) nga centralet hidroelektrike (HEC-et) mbasi TEC-i i Vlores u komisionua ne fund te vitit 2009.

Gjate vitit 2009 prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike nga shoqerite publike te gjenerimit ka qen 5,110 Milion kWh, kurse prodhimi total qe merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 89,3 Milion kWh arrin ne 5,200 Milion kWh.

Viti 2009 nga pikpamja hidrogjike vleresohet si nje vit i lagesht, gjë që ka ndikuar pozitivisht ne prodhimin e energjise elektrike ne vend. Ne grafikun e figures -2.1. – eshte paraqitur per krahasim prodhimi publik i energjise elektrike per vitet 2007, 2008 dhe 2009. Ne krahasim me vitin 2008 prodhimi i vitit 2009 eshte rritur me 36% kurse ne krahasim me vitin 2007 ka nje rritje prej 80%.




Figura 2.1.

(Burimi KESH,OST)

Nje analize me e hollësishme per prodhimin publik te energjise elektrike per vitin 2009 dhe per gjithe periudhen 2005-2009 konsiston ne evidentimin e prodhimit dhe te kohes se punes per cdo agregat te centraleve te ketij sektori.




Figura 2.2.

(Burimi KESHsh.a.)

. Ne grafikun e figures -2.2. - jane paraqitur prodhimet vjetore te energjise elektrike nga seicili central i sektorit publik, kurse ne figuren -2.3. - koha totale vjetore e punes se agregateve te seicilit central.

Nje dukuri e rendesishme ne punen e centraleve te sistemit, vecanerisht gjate periudhes 2008-2009, ka qene gadishmerija shume e larte e te gjithe agregateve te centraleve, kjo ne saje te realizimit me sukses te rehabilitimit dhe modernizimit te pajisjeve elektromekanike te ketyre centraleve.

Eshte me rendesi te theksohet se ne saje te kesaj gadishmerije eshte bere e mundur qe mos te derdhet asnje pike uji nga turbinat e centraleve pa ju marre me pare energjia.





Figura 2.3. (Burimi KESHsh.a.)

Nje tregues me rendesi i efektivitetit te funksionimit te HEC-eve eshte edhe analiza qe i behet shkarkimeve te ujit prej tyre.



CENTRALI/ VITI	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
HEC Fierza	0	0	1000.447	110.598	348.002	0	0	0
HEC Koman	13.29	402.803	2433.147	797.781	1293.234	0	0	42.772
HEC Vau Dejes	80.004	830.412	2803.328	2392.023	2703.086	0	0	152.875

Figura 2.4. (Burimi OSTsh.a.)

Ne grafikun e figures -2.4.- jane paraqitur shkarkimet e ujit nga HEC-et e kaskades se lumit Drin gjate periudhes 2002-2009. Shkarkimet e ujit nga portat e HEC-eve jane nje dukuri qe haset ne kushtet e prurjeve te medha te ujit te cilat rrezikojne rritjen e nivelit pertej nivelit kritik te lejuar qe lidhet me sigurine e diges. Ky lloj shkarkimi eshte i ligjshem, por nuk mund te perligjen ato shkarkime te cilat behen nepermjet turbinave duke mos marre energji elektrike per shkak te mosgadishmerise ne pune te agregateve apo ato shkarkime qe kryhen krahas importit te energjise elektrike nga KESH-i.

Per fat te mire keto dukuri i perkasin te kaluares, mbasi qe nga viti 2007 e deri me sot nuk eshte vertetuar asnje lloj shkarkimi i kesaj natyre.

Sikurse dihet HEC-i i Fierzes eshte nje central me rregullim vjetor te prurjeve, cka ndikon drejtpersedrejti dhe ne prodhimtarine e HEC-eve te Komanit dhe te Vaut te Dejes te cilet furnizohen me uje nga prurjet e rregulluara te Fierzes.




Figura 2.5.

(Burimi OSTsh.a.)

Ndermarja e e vendimit nga ana e Qeverise Shqiptare qe ndertimi i HEC-it te Skavices ti shtohet burimeve publike te energjise elektrike, eshte pa dyshim nje nisme me efektivitet shume te larte ekonomik, per faktin se Skavica perfaqson nje HEC me rregullim shumevjecar, cka pervec se do te rrise prodhimtarine e te gjithë HEC-eve egzistues mbi Drin por do te disiplinoje ne menyre rrenjesore edhe shkarkimet e ujit nga keto centrale.

Ne grafikun dhe tabelen e figures -2.5. - eshte paraqitur variacioni i prurjeve te lumit Drin ne Fierze nga vlerat minimale te ato maksimale per cdo muaj te viti 2009.

Gjate vitit 2009 perfunduan punimet per ndertimin e TEC-it te Vlores dhe ne fund te vitit u be komisionimi i tij dhe ai eshte ne gadishmeri per tu futur ne shfrytezim. Ky TEC eshte i projektuar dhe konstruktuar qe te punoj me gaz natyror, por aktualisht perdor si lende djegese nafte diesel, mbasi ende nuk eshte realizuar furnizimi i Shqiperise me gaz natyror, per pasoje kostua e prodhimit te energjise elektrike prej tij eshte shume me e larte se ajo e HEC-eve egzistues, mbasi cmimi i naftes ne tregjet nderkombetare, sikurse dihet, eshte teper i larte.

Megjithate duhet te theksojme se ai i sherben ne radhe te pare rritjes se sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike, ne kushtet kur devize e sektorit elektroenergjetik ne Shqiperi, qe nga viti 2008, eshte bere furnizimi pa nderprerje, gjate gjithe vitit, i konsumatoreve me energji elektrike.

TEC-i i Vlores ka te instaluar dy turbina nga te cilat njera turbine me gas dhe tjetra klasike, me avull me presion te larte.


2.2. Prodhimi privat i energjise elektrike

Struktura e prodhimit privat te energjise elektrike eshte paraqitur ne menyre te permbledhur ne tabelen -2.2.- Aktualisht jane ne prodhim 46 hidrocentrale me fuqi te pergjitheshme te instaluar 25,874 kW, qe i perkasin sektorit privat te

Tabela 2.2. *(Burimi ERE)*

Nr	Emri i hidrocentralit dhe kompania	Vendi	Viti ndertimit	Numri i njesive	Fuqia e instaluar kW	Niveli i tensionit kV
KOMPANITE KONCENSIONARE						
a	b	1	2	3	4	5
I	AMAL					
1	HC Xhyre	Librazhd	1989	1	250	0.4/10
II	EMIKEL					
1	HC Lenie	Gramsh	1971	2	400	0.4/10
2	HC Corovode	Skrapar	1971	2	200	0.4/10
3	HC Tucep	Bulqize	1970	1	400	0.4/10
III	SPAHIU GJANC					
1	HC Gjanc	Korce	1989	1	2960	6/35/
IV	WONDER POWER					
1	HC Bogove	Skrapar	1988	1	2500	6/35/
V	Balcan Green Energy					
1	HC Arras	Diber	1980	3	1200	6/10
2	HC Funares	Librazhd	1973	3	1000	6/10
3	HC Lure	Diber	1980	1	400	0.4/10
4	HC Lozhan	Korce	1982	1	150	0.4/6
5	HC Lunik	Librazhd	1977	1	200	0.4/10
6	HC Shoshaj	Tropoje	1973	2	230	0.4/10
7	HC Kerpice	Gramsh	1975	2	200	0.4/6
8	HC Muhur	Diber	1976	1	200	0.4/10
9	HC Borsh	Sarande	1970	1	250	0.4/10

10	HC Leshnice	Sarande	1973	2	250	0.4/10
11	HC Ujanik	Skrapar	1975	1	220	0.4/10
12	HC Barmash	Kolonje	1970	1	200	0.4/10
13	HC Piqeras	Sarande	1971	2	200	0.4/10
14	HC Homesh	Bulqize	1974	2	150	0.4/10
15	HC Voskopoje	Korce	1972	2	200	0.4/10
16	HC Rajan	Kolonje	1974	1	200	0.4/10
17	HC Marjan	Korce	1980	1	200	0.4/10
18	HC Nikolice	Korce	1975	3	500	0.4/10
19	HC Bulqize	Bulqize	1974	2	400	0.4/6
20	HC Velcan	Korce	1980	1	320	6/10
21	HC Zerqan	Bulqize	1976	2	250	0.4/6
22	HC Dukagjin	Shkoder	1973	2	640	0.4/10
23	HC Orgjost	Kukes	1970	2	400	0.4/10
24	HC Lekbibaj	Tropoje	1979	2	400	0.4/10
25	HC Treska 2	Korce	1976	1	130	0.4/10
VI	Albania Green Energy					
1	HC Smokthine	Vlore	1974	2	9200	
TOTAL					23830	
Nr	Emri hidrocentralit	Vendi	Viti ndert.	Nr.njesive	Fuqia KW	Tensioni kV
KOMPANITE PRIVATE						
VII	EN.KU					
1	HC Bicaj	Kukes	1968	1	100	0.4/10
VIII	SAROLLI					
1	HC Shpelle	Pogradec	1970	2	117	0.4/10
IX	PROJEKSION					
1	HC Rehove	Kolonje	1962	1	100	0.4/10
2	HC Treska 1	Korce	1969	2	130	0.4/10
3	HC Carshove	Permet	1966	1	70	0.4/10
X	JUANA					
1	HC Orenje	Librazhd	1972	1	75	0.4/10
XI	WTS ENERGJI					
1	HC Tamare	Shkoder	1968	1	150	0.4/10
2	HC Vukel	~~	~~	1	75	0.4/10
3	HC Selce	~~	~~	1	75	0.4/10
4	HC Vermosh	~~	~~	1	75	0.4/10
XII	MARJAKAJ					
1	HC Bene	Shkoder	1972	1	125	0.4/6/10
XIII	MAKSI ELEKTRIK					
1	HC Leskovik 1	Kolonje	1970	1	72	0.4/10
2	HC Leskovik 2	~~	~~	1	100	0.4/10
XIV	FAVINA I					
1	HC Vithkuq	Korce	1939	3	780	0.4/10
TOTAL					2044	

**Figura 2.6.***(Burimi KESH sh.a.)*

gjenerimit te energjise elektrike, nga keta, 32 HEC-e me fuqi te pergjitheshme te instaluar 23,830 kW jane me mareveshje koncensionare shtet-privat, kurse pjesa tjetër, 14 HEC-e me fuqi te pergjitheshme te instaluar 2,044 kW jane me pronar privat.

Gjate vitit 2009 prodhimi i energjise elektrike nga sektori privat ka arritur ne 89.31 GWh nga 62.026GWh te prodhuar nga ky sektor gjate vitit 2008, ose nje prodhim 43.9% me i larte. Per vitin 2009 prodhimi privat ze vetem 1.7% te prodhimit te pergjithshem te energjise elektrike. Pamvaresisht se aktualisht pesha specifike e prodhimit privat ne krahasim me prodhimin e pergjithshem nuk eshte sinjifikative, duhet te theksojme se ne te arthmen, ne saje te nje numuri te madh marveshjesh koncensionare te lidhura ne partneritetin shtet-privat keto raporte do te ndryshojne ne menyre thelbesore.

Ne grafikun e figures -2.6. - eshte paraqitur prodhimi vjetor i energjise elektrike nga cdo HEC privat dhe me koncension, kurse ne grafikun e figures -2.7.- paraqitet prodhimi privat i energjise elektrike per cdo muaj te vitit 2009.

PRODHIMI PRIVAT I ENERGJISE ELEKTRIKE 2009 (MWh)													<i>(nga gjeneruesit e PRIVAT DHE ME KONCESION)</i>
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	VITI 2009
Prodhimi	8413	8600	9531	11579	10979	8017	6697	4035	3470	3926	6209	7855	89310




Figura 2.7.

(Burimi KESH sh.a.)

Ecurija e prodhimit nga HEC-et e vegjel me pronar privat dhe me koncension gjate periudhes 2004 – 2009.

Ne grafikun e figures – 2.9. - jane paraqitur te ardhurat e realizuara nga shitja e energjise elektrike nga ana e ketyre HEC-eve gjate periudhes 2004 – 2009.

Sikurse vihet re lehtesisht tendenca e pergjitheshme e prodhimit te energjise elektrike dhe per pasoje edhe e te ardhurave ka qene dhe eshte ne nje rritje te vazhdueshme. Ne krahasim me vitin 2008 te ardhurat jane rritur me 45.3%. Ne grafikun e figures -2.10.- jane paraqitur cmimet e energjise elektrike me te cilat prodhuesit privat dhe me koncension e shesin ate te KESH-i.




Figura 2.8.

(Burimi KESH sh.a.)

Per te nxitur nismen private per investime ne ndertimin e HEC-eve te rinj me koncesion, me fuqi deri ne 15 MW, Qeveria ka autorizuar KESH-in qe te bleje te gjitha energjine elektrike te prodhuar prej tyre, me cmim te miratuar nga ERE, sipas nje formule nxitese e cila i referohet cmimeve




Figura 2.9.

(Burimi KESH sh.a.)

mesatare te importit te energjise elektrike plus nje bonus 10%. Diferencimi ne cmim ndermjet HEC-eve privat egzistues dhe atyre qe ndertohen te rinj eshte arsyetuar me ndryshimin e madh ne vleften e investimeve ndermjet ketyre dy kategori objektsh.




Figura 2.10.

(Burimi ERE)

Ne hartën e paraqitur ne Aneks -2- tregohet sistemi elektroenergetik i Shqipërisë, rrjeti elektrik i transmetimit, linjat e interkoneksionit, n/stacionet si dhe te gjitha burimet hidroenergetike publike, private dhe me koncension.

2.3. Eficiencia e prodhimit te energjise elektrike

Karakteristikat e eficiences se prodhimit te energjise elektrike burojne se pari nga natyra e burimeve gjeneruese. Ne nje sistem energjetik, si ky i yni, ku e gjithe energjia elektrike, ose ne rastin e pergjithshem, kur pjesa kryesore e saj, prodhohet nga hidrocentralet, eshte me rendesi te evidentohen tiparet themelore te ketij sistemi prej nga rjedhin me pas edhe perparesite dhe te metat e tij.

Ne analizen tone jane marre ne konsiderate keto tipare themelore:

- aftesija e akumulimit te energjise elektrike ne forme rezerve potenciale hidroenergetike,
- aftesija per rregullimin e prurjeve ne menyre vjetore.
- optimizimi i kombinimit te prodhimit me importin e energjise elektrike.
- fleksibiliteti i larte ndaj ngarkeses, cka i lejon te mbuloje lehtesisht pikun e ngarkeses,
- varesija e theksuar e prodhimit te energjise elektrike nga kushtet hidrologjike te motit.
- Shkarkimet e ujit nga rezervuaret.
- Investime relativisht me te medha per ndertimin e tyre dhe kohe me e gjate per perfundimin dhe fujen e objektit ne shfrytezim ne krahasim me TEC-et
- Shpenzime me te vogla shfrytezimi dhe mirembajtje.

Bazuar ne informacionet ditore per situaten elektroenergjetike ne vend, ERE cdo dite e ka ndjekur kete situatë dhe e ka reflektuar ate grafiksht ne menyre qe te analizoje dhe te vleresoje eficiencen e shfrytezimit te kaskades hidroenergjetike.

Ne Aneks -3- jane paraqitur grafiket ditor te prodhimit, importit, eksportit, shkembimit dhe konsumit te energjise elektrike si dhe nivelit te ujit ne rezervuarin e Fierzes, prurjeve te lumit Drin ne Fierze, shkarkimet e ujit nga kaskada e Drinit dhe rezerva hidroenergjetike e kaskades.

Ne tabelen -2.3.- paraqiten te dhena krahasuese per cdo vit te periudhes 2002 – 2009 ndermjet treguesve qe ndikojne drejtepersedrejt ne vleresimin e eficiences se prodhimit te energjise elektrike.

Tabela 2.3. (*Burimi KESHsb.a.OSTsb.a.*)

Emertimi	Viti							
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5,201
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1,884
Çmimi mesatar i importit (Euro/MWh)	30.18	30.15	35.57	40.04	47.81	69	79	48.69
Vlera e Importit (miljon Euro)	62.5	28.3	20.2	14.6	30,246.0	195.1	190.9	91.7
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300	6,593
Sasia vjetore e Ujit (Miljard m ³)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12	6.00
Konsumi Specifik (m ³ /kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.4	1.04	1.19
Ndalesat e energjise (GWh)	960	662	556	664	412	891	200	0
Ndalesat e energjise (ore/dite)	4.3	2.9	2.3	2.7	1.6	3.4	0.3	0

Sikurse vihet re, pamvaresisht se viti 2009 ka qen nje vit i favorshem nga pikpamja hidrologjike, ERE veren se performanca e KESH-gen ne shfrytezimin e rezerves hidroenergjetike te kaskades se lumit Drin ka qene e kenaqeshme. Konsumi specifik i ujit prej 1.19 m³/kWh tregon se uji eshte shfrytezuar me efikasitet te larte. Niveli e rezervuarit te Fierzes ne krahasim me vitet e meparshem eshte administruar me efektivitet me te larte, cka tregon per nje harmonizim shume te mire te importit me prodhimin vendas. Gjate vitit 2009 me gjithe reshjet e bolleshme nuk ka pasur shkarkime uji nga rezervuari i Fierzes dhe shkarkimet nga Vau i Dejes nuk kan qene te rendesishme dhe jane bere vetem mbasi te gjithe agregatet e centralit kane punuar me ngarkese maksimale.

Ne figuren -2.11.- te dhenat krahasuese te permendura me larte jane paraqitur ne menyre grafike.

Me rendesi eshte te theksojme se gjate vitit 2009 te gjithe agregatet e centraleve kan qene ne gadishmeri te plote dhe e gjithe sasija e ujit qe eshte shkarkuar nga turbinat eshte shfrytezuar plotesisht per prodhim energjie elektrike. Nje tregues i rendesishem i performances se sektorit elektroenergjetik eshte realizimi i furnizimit te konsumatoreve ne menyre te pa nderprere gjate gjithe vitit.

Zvogelimi i cmimit te importit te energjise elektrike ne tregun rajonal gjate vitit 2009 me rreth 38% krahasuar me nje vit me pare, ka ndikuar pozitivisht ne zvogelimin e shpenzimeve per importin e energjise.




Figura 2.11.

(Burimi KESH sh.a.OSTsh.a.)

Ne rritjen e efektivitetit te shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike ka ndikuar edhe eksporti dhe shkembimi i energjise elektrike ne situatat e prurjeve te medha si dhe ne transaksionet me perfitim ekonomik ndermjet eksportit dhe importit, te kryera nga ana e KESH-it.

Duke ju referuar treguesve te tre viteve te fundit, nga te cilet vitet 2007 dhe 2008 kane qene teper te thate, mund te themi se performanca e KESH-it ne administrimin e rezerves hidroenergjetike ka ardhur gjithmone duke u permiresuar.

Ndonse eshte keshtu, per nje sistem gjenerues te energjise elektrike kryesisht me HEC-e, dhe vecanerisht me burime te perqendruar ne mbi 80% te prodhimit vjetor ne kaskaden e Lumit Drin, me prurje qe variojne nga 7-8 m³/sek ne mbi 1500m³/sek, del i domozdoshem oraganizimi ne perberje te KESH-it i nje sherbimi per prognozimin hidrometeorologjik. Per kete eshte e domozdoshme qe ne grupin per perpunimin e rezerves hidroenergjetike te kete specialist hidrolog dhe ne pellgun uje mbledhes te lumit Drin (rreth 12,000 km²) te kete stacione matjeje dhe lajmerimi te karakterit hidrometeorologjik, ne menyre qe perpunimi i rezerves hidroenergjetike te kryhet ne kriteret shkencore gje qe do te parandalonte edhe mundesine e permbytjeve ne zonen e Nen Shkodres.

3. Konsumi i energjise elektrike

Viti 2009, shenon ne menyre te plote dhe perfundimtare furnizimin e panderprere te konsumatoreve me energji elektrike, duke e konsoliduar kete dukuri e cila ne menyre kronike i ka shkaktuar deme te konsiderueshme ekonomise dhe shqetesime shume te medha per nje jete normale, qytetareve. Gjate vitit 2009 te

vetmet nderprerje energjie kane qene vetem ato per shkak te defekteve ne rrjet ose per shkak te remonteve te paralajmeruara.

Duke qen keshtu, viti 2009 shpreh ne menyre objektive nivelin real te kerkeses vjetore per energji elektrike.

3.1. Kerkesa per energji elektrike

Sikurse shprehet dhe me siper, deri ne vitin 2009 nuk ka pasur nje vleresim te besueshem te kerkeses per energji elektrike. Vetem qe nga viti 2008 kur filloj furnizimi i panderprere me energji elektrike u krijuan premiset per te bere nje vleresim real dhe per te planifikuar me objektivitet kerkesen per energji ne vitet pasues.

Ne figuren -3.1.- ne menyre grafike eshte paraqitur konsumi vjetor i energjise elektrike ne Shqiperi per periudhen 1985 deri ne 2009.




Figura 3.1.

(Burimi ERE)

Rritja mesatare vjetore e kerkeses per energji gjate kesaj periudhe rezulton ne vlefte absolute me 160 GWh/Vit. Ne periudhen perpara vitit 2008, per shkak te nderprerjeve te programuara te energjise ky tregues nuk eshte real. Duke ju referuar viteve 2008 dhe 2009, rritja e kerkeses per energji ne vitin 2009 rezulton ne vlefte absolute me 292GWh me shume ndaj vitit 2008, ose me 4.6% me shume.

Sikurse dihet ne rrjetin e shperndarjes ka nje nivel te larte humbjesh jo teknike si dhe egziston faturimi “aforfe” per pasoje perseri nuk mund te pretendojme se kjo kerkesa per energji eshte absolutisht objektive, mbasi me zvogelimin e humbjeve jo teknike do te zvogelohet dhe kerkesa per energji. Duke qen keshtu gjykojme se rritja e kerkeses per energji ne te arthmen do te jete me e

moderuar se shifra 4.6%. Ne grafikun e figures -3.2.- eshte paraqitur nje grafik krahasues i konsumit total te energjise elektrike per cdo muaj, perkatesisht te viteve 2007-2009.




Figura 3.2. (Burimi ERE)

Ne vitin 2009, sikurse verehet nga grafiku dhe tabela perkatese eshte arritur konsumi me i madh historik ne vendin tone me 6.578 TWh.

3.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike shpreh ne menyre te sintetizuar edhe shkallen e zhvillimit ekonomiko-industrial te nje vendi. Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar perben 54.9% cka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkeses per energji.




Figura 3.3. (Burimi OSSHsh.a.)

Ne figuren -3.3. - eshte paraqitur ne menyre grafike struktura e konsumit te energjise elektrike sipas kategorive te konsumatoreve per vitin 2009 e shprehur ne MWh.

Nje peshe te rendesishme zene ne konsumin e energjise elektrike edhe konsumatoret buxhetor dhe jo buxhetore, te keta te fundit bejne pjese kryesisht ujesjellesit dhe hidrovoret te cilet jane edhe debitoret me te medhej ndaj OSSH-se

Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas cmimeve te energjise eshte paraqitur ne figuren -3.4. - . Edhe ne kete rast konsumatoret familjare (me cmimet perkatese 7 lek/kWh dhe 12 lek/kWh) perbejne peshen kryesore ne te ardhurat e OSSH-se.

Dominanca e konsumatoreve familjare ne konsumin e pergjithshem te energjise ne vend, per pasoje edhe ne dominancen e te ardhurave te OSSH-se, dhe problemet e mprehta qe lindin nga kjo kategori konsumatoresh me humbjet jo




Figura 3.4. (Burimi OSSH sh.a.)

teknike te energjise, perbejne nje nga faktoret me problematik ne nivelin e cmimeve te energjise elektrike, qe ka ndjeshmeri te larte sociale dhe qe kerkon




Figura 3.5. (Burimi OSSH sh.a.)

zgjidhje urgjente.

Me interes eshte edhe shperndarja e numurit te klienteve sipas cmimeve te energjise elektrike. Ne figuren -3.5.- eshte paraqitur kjo strukture konsumi ku sinjifikativ eshte fakti se 71.9% e gjithe konsumatoreve te vendit i perkasin bllokut te konsumit deri 300kWh/muaj, ose shtresave te popullsise me te ardhura me te pakta.

Nje tregues i terthorte i zhvillimit ekonomik te vendit eshte edhe treguesi i ecurise ne vite te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem. Ne figuren -3.6. eshte paraqitur kjo ecuri gjate periudhes 1985 deri ne 2009.

Tendenca e zvogelimit te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem, mbas vitit 2007 eshte nje prirje pozitive e cila lidhet pervec zvogelimit te humbjeve te energjise elektrike edhe me zhvillimin ekonomik te vendit.




Figura 3.6.

(Burimi ERE,OSSH sha.)

Nje tregues i terthorte i zhvillimit ekonomik te vendit eshte edhe treguesi i ecurise ne vite te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem. Ne figuren -3.6. eshte paraqitur kjo ecuri gjate periudhes 1985 deri ne 2009.

Tendenca e zvogelimit te konsumit familjar ndaj konsumit te pergjithshem, mbas vitit 2007 eshte nje prirje pozitive e cila lidhet pervec zvogelimit te humbjeve te energjise elektrike edhe me zhvillimin ekonomik te vendit.

Struktura e konsumit te energjise elektrike nga konsumatorët familjare, per cdo interval konsumi per periudhen Janar-Shtator 2009 eshte paraqitur ne Figuren-3.7.-

Kjo strukture konsumi eshte shume e dobishme per analizen e varianteve te cmimeve per konsumatorët familjare.

Vetem 22.6% e konsumatoreve familjare shpenzojne energji te faturuar mbi 300 kWh/muaj. Me rendesi eshte te theksohet fakti se 22% e konsumatoreve nuk konsumojne fare energji (kane lexim zero te matsit), ketu bejne pjese konsumatorët qe kane shtepi verimi ose kane ikur ne emigracion etj.




Figura 3.7.

(Burimi OSSH sha.)

Analiza e struktures se konsumit sipas fashave te konsumit si dhe sipas numrit te konsumatoreve per cdo fashe konsumi, lejon qe te analizohet me shume hollesi edhe struktura e cmimeve per konsumatorët familjar ne menyre qe te merren ne konsiderate nje numur i madh variantesh dhe te gjendet zgjedhja optimale.

Pesha specifike e energjise se konsumuar ne cdo zone te OSSH-se




Figura 3.8.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Struktura e konsumit sipas shtrirjes gjeografike evidenton faktin se 70.3 % e konsumit te pergjithshem te energjise elektrike kryhet ne ultesiren bregdetare praneadriatike ne zonat Shkoder, Tirane, Durres dhe Fier, ku eshte e perqendruar edhe pjesa me e madhe e popullsise se vendit si dhe e veprimtarive me te rendesishme te biznesit. Ne figuren -3.8.- eshte paraqitur kjo strukture.

Analiza e struktures se konsumit merr rendesi te madhe edhe per percaktimin e perpaesive ne manaxhimin me efektivitet te larte te konsumit te energjise elektrike.

3.3. Profili i konsumit te energjise elektrike

Struktura e konsumit te energjise elektrike ndikon drejtpersedrejt edhe ne profilin e ngarkeses ose te konsumit te energjise elektrike. Ne figuren -3.9.- eshte paraqitur profili i konsumit te energjise elektrike ne nje dite dimri (Dhjetor 2009), kurse ne figuren -3.10.- eshte paraqitur profili i kesaj ngarkese ne nje dite vere (Korrik 2009)

Tipar karakteristik i ketij profili eshte “gropa” e madhe e ngarkeses ndermjet oreve te nates (24 – 7) ndaj oreve te dites. Ne vlefte absolute ajo arrin ne 700MW ose 54% e ngarkeses maksimale. Nje profil i tille tregon se punohet pak ne “turnin e trete”.




Figura 3.9.

(Burimi OST sha.)

Ne dallim nga profili i ngarkeses per nje dite dimri, ne profilin e nje dite vere spikat nje pik ngarkese ne oret e mbremjes (20-23) e cila ka te beje kryesisht me intensifikimin e veprimtarise familjare ne keto ore, gjate stines se veres.

Eshte e rendesishme te theksojme se “gropa” e madhe e ngarkeses ne oret e nates krijon nje mundesi te shkelqyer per KESH-in per te kryer transaksione financiare fitimpruese nepermjet shitblerjes se energjise elektrike ne bursen rajonale te energjise.




Figura 3.10. (Burimi OST sha.)

Blerja naten e energjise elektrike me cmim te ulet, dhe akumulimi i ujit gjate oreve te nates, per ta perdorur ditën ne oret e pikut, per te prodhuar dhe shitur ne burse me cmimet e pikut, te njejten sasi energjie, perfaqson nje transaksion financiar fitimprures qe rrit eficencen e burimeve tona gjeneruese. Por qe te arrihet kjo mendojme se duhen bere disa ndryshime ne legjislacion dhe KESH-i te krijojë nje strukture te trajnuar mire per kete qellim.

Profili vjetor i konsumit te energjise elektrike eshte paraqitur ne grafikon e figures -3.11.-. Tipari karakteristik i ketij profili eshte simetria thuajse ideale e konsumit dimer-vere. Gjate periudhes se ngrohje prill-shtator ka nje konsum mesatar




Figura 3.11. (Burimi OST sha.)

pothuajse konstant kurse ne tre muajt paraardhes dhe pasardhes ka nje rritje simetrike te ngarkeses e cila spjegohet me ftohjen e motit dhe perdorimin gradual te energjise elektrike per ngrohje.

Perdorimi i energjise elektrike per ngrohje perben nje dukuri tjetër te demeshme te konsumit te energjise elektrike ne vendin tone. Gjate stines se veres, ne muajt korrik dhe gusht mer forme nje pik i ri ngarkese, i cili nga viti ne vit po behet me evident dhe lidhet me perdorimin gjithnje e ne shkalle me te gjere te pajisjeve klimatizuese.

Diferenca e ngarkeses mesatare dimer – vere, e cila kryesisht kushtezohet nga perdorimi i energjise elektrike per ngrohje gjate vitit 2009 vleresohet me rreth 300 MW ose ne rreth 30% te ngarkeses maksimale.

Konsumi maksimal ditor per vitin 2009 eshte regjistruar ne daten 22 Dhjetor ne vleren 24,170 GWh kurse konsumi minimal ditor eshte regjistruar ne daten 28 Qershor me nje vlere 13,908 GWh me nje ndryshim prej 10,262 GWh ose 42% e konsumit maksimal.

Piku i ngarkeses gjate vitit 2009 eshte regjistruar ne daten 31 Dhjetor 2009 ora 18 me vlere 1306 MW.

Verehet se gjate ketyre 3 vjeteve te fundit, ndonese konsumi ka pesuar rritje piku i ngarkeses ka pesuar nje ulje te lehte, gje qe te le te kutosh se koeficienti i mbushjes se grafikut te ngarkeses ka ardhur duke u permiresuar.

3.4. Importi i energjise elektrike.

Ne zbatim te kerkesave te Modeli Shqiptar te Tregut, importet e energjise elektrike per nevoja publike ne vendin tone, kryhen nga dy furnizues publik, ai me shumice (FPSH) ne perberje te KESH-it dhe nga OSSH. Ndersa FPSH importon energji per te plotesuar nevojat e klienteve tarimore, OSSH importon energji per te mbuluar humbjet e energjise elektrike ne sektorin e shperndarjeve. Importi i energjise elektrike nga FPSH kryhet ne zbatim te ligjit per prokurimet publike.

Nje vecori karakteristike e importeve te energjise elektrike gjate vitit 2009 eshte fakti se ne bilancin e pergjithshem import-eksport, ne muajt prill dhe maj eksportet kan qene me te medha se importet dhe bilanci eksport-import ka dale pozitiv ne dallim nga pjesa tjetër e vitit ku kemi import neto.




Figura 3.12.

(Burimi ERE, OSSH sha.)

Ne grafikun e figures -3.12.- paraqitet importi i energjise elektrike per cdo muaj te vitit 2009 si dhe krahasimi me perkateset e viteve 2007 dhe 2008.

Ndryshimi i importeve te vitit 2009 ne krahasim me te meparshmit eshte jo vetem i madh ne sasi por dhe ne koncept. Per shkak te kushteve te favorshme hidrologjike, prodhimi vendit ka qen me i madh dhe ndonse edhe konsumi ka qen me i madh, importet kane qene me te vogla, dhe nga ana tjeter ne muajt prill, maj sistemi u kthye edhe ne ekSPORTUES neto i energjise elektrike. Ne dallim nga vitet e tjera gjat vitit 2009 vendi yne pervec importues ka qene edhe eksportues i energjise elektrike.




Figura 3.13. (Burimi ERE,OSSH sha.)

Ne figuren -3.13.- ne menyre grafike eshte paraqitur ecurija e prodhimit, importit dhe konsumit te energjise elektrike gjate periudhes 2002 - 2009




Figura 3.14. (Burimi ERE,OSSH,KESH)

Eshte sinjifikativ fakti se gjate viteve 2007- 2009 importet e energjise elektrike jane importet me te medha historike dhe vecanerisht ne vitin 2009, kur prodhimi vendas ka qen i larte. Nje gje e tille reflekton parimin e rendesishem udheheqes te pergjegjesise shteterore per te garantuar me cdo kusht nje furnizim te pandërprere me energji elektrike te konsumatoreve mbasi energjia e munguar ka cmimin me te larte per ekonomine.

Ne figuren -3.14.- jane paraqitur sasite e importit gjate periudhes 2002 – 2009.

Ne figuren -3.15.- jane paraqitur cmimet e importit te energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2009.




Figura 3.15.

(Burimi ERE,OSSH,KESH.)

Ne figuren -3.16.- jane paraqitur financimet qe jane kryer gjate periudhes 2002- 2009 per te siguruar sasite perkatese te energjise elektrike, kundrejt cmimeve perkatese te importit.




Figura 3.16.

(Burimi ERE,OSSH,KESH.)

Shpenzimet per blerjen e energjise elektrike nga importi ne vitet 2007 dhe 2008 jane rekordi historik i shpenzimeve, dhe kjo jo vetem ne saje te sasive rekord te importuara por edhe ne saje te cmimeve rekord te importit te energjise.

Duke pare keto bilance te importeve te energjise elektrike, mund te thuhet me te drejte se energjia elektrike perfaqson nje produkt me kosto shume te larte qe per pasoje duhet te perdoret me eficience shume te larte.

3.5. Efienca e konsumit te energjise elektrike.

Ne se ne prodhimin publik te energjise elektrike efienca e kesaj veprimtarie po vjen duke u rritur nga viti ne vit, nuk mund te themi te njejten gje per eficiencen e konsumit te energjise elektrike.

Faktoret qe determinojne uljen e eficiences se konsumit te energjise elektrike jane:

- Niveli i larte i humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje. Humbjet totale dhe humbjet jo teknike dhe teknike ne vecanti, kane nivele te papranueshme, cka reflektohet ne nivelin e ulet te faturimeve te energjise elektrike ndaj konsumit te pergjithshem.
- Niveli i ulet i arketimeve te energjise elektrike te faturuar.

Ne grafikun e figures -17.- eshte paraqitur niveli i humbjeve, arketimeve dhe efektivitetit per seicilen nga zonat e shperndarjes gjate vitit 2009.

Humbjet e pergjitheshme ne shperndarje gjate vitit 2009, sipas raportimit vjetor te OSSH-se jane ne nivelin 33.98% te energjise se pergjitheshme te injektuar ne sistemin e shperndarjes, kurse niveli i arketimeve eshte raportuar me 76.4% te energjise elektrike te faturuar.




Figura 3.17.

(Burimi ERE,OSSH,)

Koeficienti vjetor i efektivitetit per sistemin e shperndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor te humbjeve dhe te arketimeve) rezulton me 50.4%. Verehet qarte se niveli i eficiences ne shperndarje eshte shume i ulet cka do te thote se nga

100 kWh te futur ne rrjetin elektrik te shperndarjes, arketohet vlefta e vetem 50.4 kWh.

Eficienca e ulet ne konsumin e energjise elektrike vjen si pasoje e nje menaxhimi te dobet te sektorit te shperndarjes nga ana e OSSH-se. Privatizimi i OSSH-se deri tani nuk ka reflektuar akoma ndonje kthese ne mirmenaxhim, perkundrazi niveli i arketimeve per vitin 2009 eshte perkeqesuar ne menyre te ndjeshme ne krahasim me nje vit me pare.




Figura 3.18.

(Burimi ERE,OSSH,)

Ne sistemin e transmetimit humbjet e energjise elektrike jane ne vleften 211 GWh dhe perbejne 3% te energjise se injektuar ne sistemin e transmetimit. Humbjet totale faktike per vitin 2009 te cilat marrin parasysh humbjet ne shperndarje me 2,117 GWh dhe humbjet ne transmetim me 211 GWh jane gjithesej 2,328 GWh ose 35.3% e gjithe energjise se injektuar ne sistemin elektroenergjetik te vendit.




Figura 3.19.

(Burimi ERE,OSSH,)

Ne grafikun e figures -3.18.- eshte paraqitur ecurija e humbjeve gjate periudhes 2002 – 2009 kurse ne grafikun e figures -3.19.- eshte paraqitur mardhenia e faturim-arketimeve gjate se njeites periudhe.

Ne grafikun e figures -3.20.- eshte paraqitur struktura e humbjeve dhe faturimeve per seicilen nga zonat e shperndarjes se OSSH-se per vitin 2009, dhe pesha specifike qe zen ato ne bilancin e pergjithshem te kompanise.




Figura 3.20. (Burimi ERE,OSSH,)

Zonat me treguesit me te ulet te efektivitetit jane Kuksi, ku arketohet vetem 9.5% e energjise se faturuar dhe pas tije Shkodra dhe Burreli me perkatesisht 31.2% dhe 39.6% arketime te energjise se faturuar.

Por peshen specifike me te madhe ne nivelin e efektivitetit te konsumit te energjise elektrike e kane zonat e Tiranës, Durresit, Fierit dhe Shkodres.




Figura 3.21. (Burimi ERE,OSSH,)

Nga nje analize e tille e situates ne zonat e OSSH-se rezulton se per te patur ndryshim te shpejte pozitiv te situates, persa i perket rritjes se efektivitetit, vemendja kryesore ne manaxhim dhe ne investime duhet te drejtohet ne 4 zonat kryesore te permendura me larte, duke mos lene pas dore edhe zonat e tjera problematike.

Ne grafikun e figures -3.21.- eshte paraqitur situata e pajisjes me matesa te konsumatoreve tarifore deri ne fund te vitit 2009. Ne shkalle vendi rezultojne pa matje 7.6% e konsumatoreve tarifore, ose 83,973 konsumatore. ERE duke marre ne konsiderate kohen e pamjaftueshme ne dispozicion te OSSH-se, mbas privatizimit, per plotesimin e konsumatoreve me matesa, me Vendimin nr.104 date 22.12.2009, vendosi qe te shtyje afatin e faturimit te ashtuquajtur “aforfe” deri me 30 Prill 2010.

ERE plotesimin me matesa te te gjithe konsumatoreve tarifore e konsideron nje objektiv me shume rendesi qe ndikon pozitivisht ne zvogelimin e perdorimit pa limit te energjise elektrike, ne rritjen e arketimeve, zvogelimin e humbjeve jo teknike dhe zvogelimin e kerkeses per energji. Duke qene keshtu ERE do te monitoroje me kujdes realizimin nga ana e OSSH-se te ketij objektivi brenda afatit te caktuar.




Figura 3.22.

(Burimi ERE,OSSH,)

Nje nga treguesit kryesor te eficences se perdorimit te energjise elektrike eshte shkalla e mungeses se saj. Energjia e munguar eshte energjia me e shtrenjte, per efekt te impaktit mjaft te rende qe sjell mungesa e energjise elektrike ne jeten ekonomiko-sociale te vendit. Ky koncept teper racional, ka qene devize e Qeverise Shqiptare qe nga viti 2006. Gjate viteve 2007 dhe 2008 u shpenzuan nga Qeveria, deri ne kufijt e te pamundures, 388 Milion Euro, per importe te energjise elektrike, ne menyre qe mungesa e saj, per shkak te thatesires se skajshme dhe konjukturave aspak te favorshme te tregut rajonal, te ndikonte sa me pake ne jeten e vendit.

Deri ne vitin 2008 furnizimi me energji elektrike eshte kryer me nderprerje te detyruara. Ne grafikun e figuren -3.22.- paraqiten nderprerjet e energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2009. Vetem dy vitet e fundit ne Shqiperi kane munguar nderprerjet e programuara.

Prodhimi,importi,eksporti,shkembimi 2009




Figura 3.23.

(Burimi ERE,OSSH,OST,)

Bilanci i pergjithshem i energjise elektrike per vitin 2009 eshte paraqitur ne grafikun e figures -3.23.-. Ne kete grafik paraqitet struktura e ketij bilanci, e cila shpreh prodhimin e energjise elektrike nga seicili prodhues dhe po ne te njejten menyre edhe importin, eksportin dhe shkembimin e energjise elektrike nga shoqerite publike qe operojne ne treg. Edhe viti 2009 ne total eshte nje vit qe na karakterizon si nje vend importues neto te energjise elektrike pamvaresisht se gjate muajve prill dhe maj kemi qene eksportues.

4. Operatori i Sistemit te Transmetimit

Sistemi i transmetimit te energjise elektrike perfaqson bashkesine e linjave elektrike, n/stacioneve dhe instalimeve te tjera (mjeteve kompensuese etj) qe sherbejne per transmetimin dhe interkoneksionin nderkombetar te energjise elektrike.

Sistemi i transmetimit drejtohet nga Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST), i cili eshte i licensuar nga ERE per te kryer veprimtarine e transmetimit te energjise elektrike. OST eshte shoqeri publike me 100% te aksioneve shteterore.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese per furnizimin e panderprere te konsumatoreve me energji elektrike. Ne kete kuader ai zhvillon sistemin e transmetimit ne perputhje me kerkesen afatgjate te furnizimit te vendit me energji elektrike.

OST dispeceron sistemin elektroenergjetik nepermjet manaxhimit te flukseve te energjise ne sistem duke marre parasysh realizimin e te gjitha sherbimeve ndihmese qe lidhen me qendrushmerine e sistemit si dhe shkembimet me sistemet e tjera.

Nje rol tjetër i rendesishem eshte edhe ai i Operatorit te Tregut te Energjise Elektrike. Ne kete kuader roli i tij nuk ka te beje me transaksione financiare qe lidhen me importet ose eksportet e energjise elektrike.

Funksionimi i Sistemit te Transmetimit kryhet ne perputhje me ligjin “Per Sektorin e Energjise Elektrike” dhe dispozitat e Kodit te Funksionimit te Rrjetit i cili miratohet nga ERE.

4.1. Struktura e Operatorit te Sistemit te Transmetimit

Struktura e OST-se ne menyre te permbledhur eshte paraqitur ne Tabelen -4.1. -

Tabela 4.1.

(Burimi OST)

Linja elektrike transmetimi			
Tipi i Linjes	Tensioni ne kV	Gjatesia ne km	
Linje elektrike transmetimi, ajrore	110	1216.2	
Linje elektrike transmetimi, ajrore	150	34.4	
Linje elektrike transmetimi, ajrore	220	1128	
Linje elektrike transmetimi, ajrore	400	120.2	
Linja elektrike interkoneksioni ndershteterore			
Emertimi i linjes	Kapaciteti MVA	Tensioni ne kV	Gjatesia ne km
Linje transmetimi ajrore Fierze-Prizren (Shqiperi-Kosove)	220	220	68
Linje transmetimi ajrore Vau i Dejes-Podgorice (Shqiperi-Mal i Zi)	210	220	44.75
Linje transmetimi ajrore Bistrice 1- Myrtos (Shqiperi-Greqi)	100	220	47
Linje transmetimi ajrore Zemblak - Kardia (Shqiperi-Greqi)	1000	400	20
Nenstacione elektrike			
Emertimi	Kapaciteti MVA	Tensioni kV	Sasia
Nenstacion	750	400	2
Nenstacion	2126	220	11
Nenstacion	40	150	1

Ne Aneks -2- eshte paraqitur shtrirja ne teren e sistemit te transmetimit te energjise elektrike.

4.2. Zhvillimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit

Investimet e kryera ne vitin 2009 ne OST jane rreth 22 milion USD, nga te cilat 10 milion nga donatoret e Huaj dhe 12 milion nga vete OST Sh.a.

Tabela 4.2.*(Burimi OST,)*

Emertimi	Vlefta ne Milion Leke	Gjatsija ne km	Afati sherbimit ne vjet
Linje ajrore 110 kV, Rashbull-Porto Romano	50.85	6.5	25
Linje ajrore 110 kV dhe hyrje ne n/stacionin Elbasan	20.72	0.2	25
Linje ajrore 110 kV Kucove-Uznove	123.25	14	25
N/Stacion Rashbull	46.43	--	30
Linje ajrore Bistrice 1 - Sarande	111.26	12	25
Rehabilitim N/Stacioneve 220kV ne HEC-et Fierze dhe Vau i Dejes	1,324.95	--	30
Kontroll-Monitorimi i N/Stacioneve 220 kV ne Tirane dhe Elbasan	148.00	--	30
N/Stac.Koplik, fuqizim N/Stac.dhe linjes ajrore 110 kV, Vau Dejes	1,342.14	0.1	30
Linje ajrore 110 kV, Kalimash	1,636.90	8.2	25
N/Stacion 110 kV, Kalimash	54.22	--	30
Pajisje, makineri etj.	195.89	--	--
Totali	7,273.47	--	--

Ne tabelen -4.2.- jane paraqitur te gjitha investimet e perfunduara ne vitin 2009, por qe i perkasin nje periudhe disa vjecare te realizimit te tyre.

5. Operatori i Sistemit te Shperndarjes

Sistemi i shperndarjes se energjise elektrike perfaqson bashkesine e linjave elektrike ajrore dhe kablore, n/stacioneve dhe instalimeve te tjera (kabina transformuese etj) qe sherbejne per shperndarjen e energjise elektrike.

Sistemi i shperndarjes drejtohet nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH), i cili eshte i licensuar nga ERE per te kryer veprimtarine e shperndarjes se energjise elektrike. OSSH eshte shoqeri aksionere me 76% te aksioneve te zoteruara nga Kompania Ceke CEZ dhe 24% nga Qeveria Shqiptare. Procesi i privatizimit te OSSH-se perfundoi gjate vitit 2009 dhe qe nga 1 Qershori i ketij viti, OSSH operon si nje shoqeri private.

OSSH ka per objekt te veprimtarise se vet mbajtjen dhe zhvillimin e nje sistemi te sigurte dhe eficient shperndarjeje per te garantuar nje furnizim me cilesi dhe pa nderprerje me energji elektrike te konsumatoreve te lidhur ne kete sistem. OSSH kryen edhe importet e energjise elektrike deri ne ate mase sa te mbuloje humbjet e energjise elektrike ne shperndarje.

Funksionet e kryerjes se furnizimit me energji elektrike dhe te gjitha procedurat e faturimit dhe arketimit te energjise elektrike te shitur te konsumatoret tarifore kryhen nga Furnizuesi Publik me Pakice (FPP), qe perfaqson nje subjekt publik te pavarur financiarisht dhe organizativisht nga OSSH-ja por qe juridikisht eshte pjese e saj. FPP per furnizimin e konsumatoreve tarifore blen me cmime te rregulluara nga Furnizuesi Publik me Shumice (FPSH), te gjitha energjine elektrike

te prodhuar ne vend dhe te importuar prej tij (FPSH), per plotesimin e nevojave te konsumatoreve tarifore.

5.1. Struktura e Sistemit te Shperndarjes

Ne tabelen -5.1.- eshte paraqitur struktura e pergjitheshme e Sistemit te Shperndarjes, nepermjet se ciles realizohet ne praktike furnizimi me energji elektrike i konsumatoreve tarifore te rrjetit te shperndarjes.

Tabela 5.1.

(Burimi OSSH,)

Sistemi i Shperndarjes -2009-	
Numri i Zonave te Shperndarjes	10
Numri i Agjensive te shperndarjes	41
Numri i Njesive te Tensionit te Larte	5
Numri i Nen/Stacioneve	167
<i>Nr. N/Stacioneve 110 kV</i>	<i>70</i>
<i>Nr. N/Stacioneve 35 kV</i>	<i>97</i>
Numri i Kabinave	21984
<i>Kabina 6 kV</i>	<i>10648</i>
<i>Kabina 10 kV</i>	<i>8448</i>
<i>Kabina 20 kV</i>	<i>2888</i>
Gjatesia e Linjave	
Linja 35 kV (km)	1143
Linja 20 kV (km)	965
<i>Kabllore (km)</i>	<i>923</i>
<i>Ajrore (km)</i>	<i>41</i>
Linja 10 kV (km)	7382
<i>Kabllore (km)</i>	<i>241</i>
<i>Ajrore (km)</i>	<i>7141</i>
Linja 6 kV (km)	5006
<i>Kabllore (km)</i>	<i>329</i>
<i>Ajrore (km)</i>	<i>4677</i>
Linja 0.4 kV (km)	27666

<i>Kabllore (km)</i>	3774
<i>Ajrore (km)</i>	23892

Numri i konsumatoreve	1110909
<i>Familjare</i>	965724
<i>Private</i>	133883
<i>Buxhetore + JoBuxhetore</i>	11302

6. Privatizimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes

6.1 Zhvillimi i procesit te privatizimit

Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH) ka qene pjese e Korporates Elektro Energjetike (KESH) deri ne Dhjetor te vitit 2006. Ndarja e OSSH nga KESH dhe krijimi i OSSH sh.a u aprovua ne Dhjetor te vitit 2006 nepermjet VKM nr. 862 “Mbi krijimin e kompanise OSSH sh.a”. Ne 30 Maj te viti 2007 bordi mbikqyres i KESH aprovoi krijimin e OSSH sh.a dhe 19 Qershor te vitit 2007 OSSH sh.a u regjistrua ne gjykatën e Tiranës. Ndarja e funksionit te shperndarjes nga KESH sh.a shenoi edhe hapin e pare drejt procesit te privatizimit te OSSH sh.a.

Si keshilltar i transaksionit per te asistuar qeverine e Shqiperise gjate procesit te ristrukturimit dhe privatizimit te OSSH sh.a. u zgjodh Korporata Financiare Nderkombetare (IFC). Mbas procesit Due-Diligence, IFC dorezoi nje raport me rekomandimet perkatese per Ministrine e Ekonomise Tregetise dhe Energjetikes (METE), KESH dhe per Regullatorin e Energjise (ERE) ne lidhje me detyrat qe duheshin kryer per te realizuar procesin e privatizimit.

ERE kishte detyrimin te pergatiste dhe te dorezonte ne qeveri draftin e Modelit Shqiptar te Tregut si edhe te rishikonte te gjithe legjislacionin sekondar me qellim qe ta peputhte ate me Modelin e tregut. Modeli Shqiptar i tregut u aprovua nga qeveria ne Mars te vitit 2008. Sipas ketij Modeli, OSSH sh.a. do te kryente dy aktivitete; aktivitetin e shperndarjes (mirembajtjen, zgjerimin dhe operimin e sistemit te shperndarjes ne territorin e Shqiperise) dhe aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakice (FPP)(shitjen e energjise vetem per konsumatorët tarifore sipas nje kontrate termat dhe tarifat e se ciles jane te aprovuara nga ERE). Per te zgjidhur problemin e riskut hidrologjik prane KESH sh.a. u krijua nje division i vecante qe u quajt Furnizuesi Publik me Shumice i cili do te merte pergjegjeite e furnizimit te vendit me energji pavaresisht nga situata hidrologjike.

Forma dhe formula e privatizimit te OSSH sh.a u percaktuan ne ligjin nr. 9899 ne 20 Mars te vitit 2008. Sipas ketij ligji, privatizimi do te kryejej nepermjet nje tenderi te hapur nderkombetar me nje faze parakualifikimi dhe jo me pak se

51% por jo me shume se 76% te aksioneve do ti ofroheshin investitorit strategjik. Pas fazes parakualifikuese, ne Maj te vitit 2008, u njoftua se vetem 4 kompani u parakualifikuan (CEZ, ENEL, ESTAG dhe EVN). Ne baze te ligjit te lartepemendur procedurat e vleresimit te ofertave dhe kriteret e zgjedhjes se fituesit te privatizimit te OSSH sh.a. do te percaktoheshin me Vendime te Keshillit te Ministrave. Sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave (VKM) nr. 835, ne Qershor te vitit 2008, do te ofroheshin per privatizim 76% te aksioneve te OSSH sh.a. dhe ne aneks te kesaj VKM-je ishin instruksionet per realizimin e tenderit te privatizimit. Tenderi u zhvillua ne 29 Shtator te vitit 2008, ku vetem dy kompani paraqiten ofertat e tyre. Nje muaj me vone, ne 29 Tetor 2008, qeveria shpalli fituesin e tenderit i cili ishte kompania CEZ nga Republika Ceke. Periudha ndermjet Nentorit 2008 dhe Marsit 2009 ishte periudha ku u zhvilluan negociatat ndermjet kompanise fituese dhe qeverise shqiptare per negociimin e Mareveshjes se Shitjes se Aksioneve dhe Deklarates Rregullatore (e cila ishte ne aneks te kesaj Mareveshje).

Mareveshja e Blerjes se Aksioneve midis METEs dhe CEZ u aprovua ne parlament ne 23 Prill te vitit 2009 me ligjin nr. 10 116. Kjo mareveshje pervec kushteve paraprake dhe cmimit te shitjes se 76% te aksioneve te OSSH sh.a. percakton detyrimet e bleresit dhe shitesit. Zgjidhja e mosmareveshjeve qe kane lidhje me kete mareveshje sipas nenit 13 te saj do te behet sipas Rregullave te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregetise. Arbitrazhi do te zhvillohet ne Viene (Austri) dhe procedura e arbitrazhit do te zhvillohet ne gjuhen angleze. Mbyllja e gjithë procesit te privatizimit dhe kalimi i OSSH sh.a. tek kompania CEZ eshte bere ne 29 Maj te vitit 2009.

6.2 Deklarata Rregullatore (DR)

Deklarata Rregullatore (DR) eshte pjese e Mareveshjes se Blerjes se Aksioneve dhe eshte vendosur ne aneks te saj. Megjithate DR ishte nje nga elementet me kryesore te gjithë procesit te privatizimit. Ajo mbulon tre periudha rregullatore duke filluar nga viti 2010 deri ne fund te vitit 2014 dhe qellimi i saj eshte te beje te mundur llogaritjen e tarifave te gjenerimit publik, te furnizimit me shumice, shperndarjes dhe furnizimit me pakice. Sipas Modelit Shqiptar te Tregut, Furnizuesi Publik me Shumice blen energji nga gjenerimi publik, prodhuesit e tjere te vegjel dhe importi dhe e shet miksion e energjise tek Furnizuesi Publik me Pakice me cmim te rregulluar. Norma e kthimit per gjenerimin publik eshte vendosur norma e kthimit mbi Bonot e Thesarit aftashkurtra te emetuara nga Banka e Shqiperise.

Kompania e Shperndarjes operon mbi bazen e cmimit tavan (price-cap formula) dhe faktori X eshte vendosur te jete i barabarte me zero per tre periudhat e para rregullatore. Llogaritja e Kostos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WAAC) eshte gjithashtu nje element i rendesishem i Deklarates Rregullatore. Raporti i

pranuar i borxhit per qellim te llogaritjes se tarifes se shperndarjes do te jete 60% borxh dhe 40% kapital i vet. Norma e Kthimit mbi Kapitalin e Vet (ROE) eshte fiksuar ne 16.44% per te tre periudhat e para rregullatore. Ne DR nuk eshte percaktuar ndonje shifer ne lidhje me koston e borxhit por ERE per qellimin e llogaritjes se WAAC-ut do te perdore vleresimin me te fundit te koston mesatare te ponderuar te borxheve te reja te mara nepermjet procedurave transparente te tenderimit te OSSH-se.

Pavaresisht perpjekjeve per te reduktuar humbjet, niveli total i tyre ne rjetin e shperndarjes ka qene relativisht i larte per nje periudhe te gjate kohe. Sipas Modelit te Tregut me qellim nxitjen e kompanise per te reduktuar nivelin e humbjeve totale ajo do ta bleje energjine qe i duhet per te mbuluar humbjet ne rrjetin e shperndarjes ne treg dhe jo me nje cmim te rregulluar. Niveli i deklaruar i humbjeve nga OSSH per vitn 2008 eshte 32.74% e energjise se injektuar ne rrjetin e shperndarjes. Ndarja e kesaj shifre ne humbje teknike dhe humbje jo-teknike deri tani eshte percaktuar nga kompania ne menyre apriori pa u bazuar ne ndonje studim te mirefillte. Ne lidhje me kete ceshtje ne DR eshte percaktuar qe kompania do te kryeje nje studim specifik per te percaktuar nivelin e humbjeve teknike dhe jo-teknike ne rrjetin e shperndarjes dhe ky studim eshte subjekt i aprovimit nga ERE. Meqenese humbjet jane pjese e rendesishme e tarifes se energjise ERE ka vendosur targete per reduktimin e tyre per te treja periudhat rregullatore. Kompania duhet ti reduktoje humbjet prej 4% cdo vit per dy periudht e para rregullatore dhe 9 % per periudhen e trete rregullatore (nga 3% per cdo vit). Deri ne fund te vitit 2014 kompania ka per detyre te reduktoje humbjet me 17%. Ne cdo rast kompania do te perfitoje nga reduktimi i humbjeve mbi targetin e vendosur nga ERE, por kuptohet do te paguaje koston e mosarritjes se ketij targeti.

Borxhi i keq ose debitoret pa shprese arketimi jane gjithashtu nje ceshtje e rendesishme per kompanine dhe qe eshte pjese e Deklarates Rregullatore. Eshte negociuar qe niveli i borxhit te keq per aplikimin per tarife per periudhen e pare rregullatore te jete ne nivelin 14% (te te ardhurave te kerkuara dhe te njohura te FPP-se). Megjithate kompania ka obligim te kryeje nje studim qe te percaktoje ne menyre te sakte nivelin e borxhit te keq brenda fundit te Korrikut te vitit 2011 dhe ky studim eshte subjekt i aprovimit nga ERE. Nese studimi tregon qe niveli real i borxhit te keq eshte me i larte se 14%, atehere kompania do te kompensohet per diferencen ne vitet pasardhes, dhe e kunderta nese studimi tregon se niveli eshte me i ulet se 14% atehere ERE do tia marre diferencen kompanise duke axhustuar tarifen ne periudhen pasardhese. Deklarata Rregullatore ka gjithashtu te percaktuar objektivat per zvogelimin e borxhit te keq gjate tre periudhave rregullatore qe ajo mbulon. Kompania ka obligim ta zvegeloje borxhin e keq me 1% cdo vit deri ne fund te vitit 2014. Sebashku humbjet dhe borxhet e keqija kane kontribuar ne situaten e veshtire financiare te kompanise. Pritet qe permiresimi i nivelit te humbjeve dhe borxhit te keq te kene nje presion zbrites ndaj cmimit ne te ardhmen.

Nje pjese e rendesishme e DR eshte edhe mekanizmi i kompesimit. Ne rast se ERE nuk lejon ne tarifen e nje viti te caktuar nje pjese te te ardhurave te

kerkuara dhe te njohura te kompanise, atehere kjo pjese e te ardhurave do te perbeje llogarine e kompesimit dhe do te jete objekt i mekanizmit te kompesimit. Me fjale te tjera nese kerkesa per te ardhura OSSH-se ne funksionin e saj si FPP, dhe te njohura nga ERE, per nje vit rezulton me nje rritje te tarifes totale mesatare te ponderuar me te larte se 15% ne terma reale atehere ERE do te rrise tarifen te pakten 15% ne terma reale dhe diferencen do ta kaloje ne llogarine e kompesimit qe do ti kompesohet kompanise ne vitet pasardhese. Por nese rritja e kerkuar dhe e njohur e tarifes fundore totale mesatare e ponderuar per vitin e ardhshem eshte me ulet se 15% ne terma reale atehere ERE do te miratoje ate rritje qe rezulton nga llogaritjet (pra me e ulet se 15% ne terma reale) pa kaluar asnje pjese te te ardhurave ne llogarine e kompesimit. Gjate periudhes se kompesimit OSSH ka te drejten te fitoje kthimin e rregulluar mbi kete shume qe ka qene objekt i mekanizmit te kompesimit.

6.3 Garancia e Riskut Rregullator

Pjese e procesit te privatizimit kane qene edhe dy mareveshje te tjera te cilat gjithashtu jane ratifikuar ne parlament ne Maj te vitit 2009; Mareveshja e Mbeshtetjes Qeveritare (ndermjet Ministrise se Finances se Republikes se Shqiperise, Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjetikes dhe OSSH sh.a) dhe Mareveshja e Garancise se Riskut Pjesor (ndermjet qeverise se Shqiperise dhe Bankes Nderkombetare per Rindertim dhe Zhvillim, IBRD). Te dyja keto mareveshje jane ngushtesisht te lidhura me njera tjetren. Qellimi i Mareveshjes se Garancise se Riskut Pjesor eshte te mbuloje riskun rregullator qe lidhet me aktivitetin e OSSH sh.a si nje kompani private. Ministria e Finances e Republikes se Shqiperise eshte garantuesi i shumes qe do ti kompensohet kompanise ne rast te nje demi financiar te shkaktuar nga nje vendim i padrejte (sipas kompanise) i ERE-s. Keshtu Mareveshja e Mbeshtetjes Qeveritare tregon procedurat e ankimit te kompanise prane qeverise shqiptare ne lidhje me nje vendim te padrejte te EREs (sipas tyre) dhe procedurat e shqyrtimit te kesaj ankese deri ne vendimin perfundimtar nese kompania ka ose jo te drejte per te terhequr shumen e garantuar sipas llogaritjes qe i eshte bere demit financiar te shkaktuar.

7. Siguria e furnizimit me energji elektrike

Objektivi themelor i veprimtarive ne sektorin e energjise elektrike eshte pa dyshim furnizimi ne menyre te panderprere dhe me cilesi i konsumatoreve me energji elektrike per sote dhe per te arthmen.

Viti 2009 demonstroi nje furnizim te panderprere te konsumatoreve me energji elektrike dhe per pasoje konsumi prej 6.592 TWh perfaqson edhe kerkesen reale per energji elektrike, e cila sherben si pike mbeshtetje per skenaret e prognozimit te kerkeses per energji elektrike per periudhat afatshkurter dhe afatgjata.

Skenaret e kerkeses per energji elektrike sherbejne per te hartuar skenaret e furnizimit me energji elektrike, dhe ata jane pjese e strategjise kombetare te energjise.

Sigurija e furnizimit, sikurse dihet, perfaqson nje koncept te gjere dhe mjaft kompleks, mbasi eshte funksion i shume variableve, si i skenarit te zhvillimit te burimeve gjeneruese ne vend, i rezerves gjeneruese, i struktures se interkoneksioneve ndershtetore, i shkalles se eficiences se prodhimit dhe konsumit te energjise elektrike, i shkalles se sigurise se rrjeteve dhe sistemeve te transmetimit dhe te shperndarjes, i shkalles se automatizimit te tyre, i kualitetit te manaxhimit te ketyre sistemeve, i dinamikës së zhvillimit te kerkeses per energji etj.

Strategjia e Qeverise Shqiptare per rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike udhheqet se pari nga shfrytezimi ne maksimum i potencialit te madh hidroenergjetik te vendit i cili eshte ende i pashfrytezuar. Shfrytezimi i tije parashikohet te realizohet kryesisht nepermjet investimeve private. Viti 2009 shenoi nje shkalle te larte pjesmarjeje te investitoreve privat qe u kurorezua me mbi 150 propozime nga ana e tyre per ndertim HEC-esh dhe me 90 kontrata koncensionare te cilat parashikojne instalimin e nje fuqie gjeneruese 826.5 MW, nje prodhim vjetor prej 3.13 TWh dhe nje investim te pergjithshem gjate 5-6 vjeteve te ardhshem prej 719 Milion Euro.

Se dyti, nje drejtim i rendesishem eshte diversifikimi i burimeve gjeneruese. Ne kete kuader gjate vitit 2009 u fut per here te pare ne pune, mbas nje pauze 24 vjecare, i pari burim i rendesishem gjenerues, TEC-i i Vlores, me cikël te kombinuar, me fuqi te instaluar 98 MW, me nje teknologji bashkekohore dhe rendiment te larte. Krahas tij vazhdojne negociatat per arritjen e nje mareveshjeje koncensionare per ndertimin e nje TEC-i me qymyr ne Porto-Romano (prane Durresit) me fuqi te instaluar rreth 800 MW si dhe mareveshja per ndertimin ne bashkepunim me Qeverine e Kosoves te nje TEC-i me lignit ne Kosove per ti sherbyer te dy shteteve.

Nga ana tjeter licensimi i nje numuri te rendesishem investitoresh private per te ndertuar parqe eolike ne teritorin e Shqiperise, me nje fuqi te pergjitheshme te instaluar rreth 1,350 MW dhe prodhim te pritshem vjetor rreth 4.1 TWh, qe parashikon nje investim rreth 2 miliard Euro, perben nje drejtim tjeter te diversifikimit te burimeve gjeneruese ambjentalisht miqesore.

Ne strategjine e vete Qeverija Shqiptare e vlereson nje obsion real edhe ndertimin e nje centrali nuklear me karakter rajonal nepermjet siper marrjes private per te siguruar nje furnizim te sigurte e te qendrushem afatgjate, me energji elektrike ambjentalisht miqesore, te Shqiperise dhe vendeve fqinje ne rajon. Per krijimin e kuadrit te nevojshej legal dhe regullator ne perdorimin paqesor te energjise nukleare, gjate vitit 2009 u themelua nje agjenci e posacme qeveritare.

Hapa shume te rendesishem ne rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike jane edhe zhvillimi i linjave ndershtetore te interkoneksionit. Mbas perfundimit ne vitin 2010 te linjes ajrore te interkoneksionit me tension 400 kV dhe kapacitet 1,000 MW, Elbasan-Tirane-Podgorice, do te filloje menjehere, me financime te Qeverise Gjermane, linja e interkoneksionit Tirane-Prizren-Prishtine

gjithashtu me tension 400 kV dhe kapacitet 1,000 MW. Ne vijim parashikohet te ndertohej edhe linja e interkoneksionit me Maqedonine, duke ju shtuar ketyre dhe dy linjat kablore nenujore te interkoneksionit me Italine, Shqiperia do te pozicionohet ne menyre shume efektive dhe te sigurte nga pikpamja e konfiguracionit te sistemeve te transmetimit ne rajonin e tete energjetik te Evropes.

Integrimi i sistemit energjetik te Shqiperise me ate te Kosoves do te rrise ne menyre te ndjeshme eficiencen e funksionimit te ketyre dy sistemeve komplementare dhe do ti sherbeje rritjes se metejshtme te sigurise se furnizimit me energji elektrike te ketyre dy shteteve.

Investimet gjithnje ne rritje nga shoqerite qe operojne sistemet elektrike te transmetimit (OST) dhe te shperndarje (OSSH) nepermjet zgjerimit dhe modernizimit te tyre si dhe automatizimit ne shkalle te larte, do te sherbejne gjithashtu, brenda nje periudhe afatmesem, jo vetem per rritjen e sigurise se furnizimit, por edhe per rritjen e cilesise se ketij furnizimi.

Investimet e realizuara ne rehabilitimin e pjeses elektromekanike te HEC-eve me te rendesishme te vendit e dhane efektin e tyre shume pozitiv gjate vitit 2009, me gadishmerine per pune te te gjithe agregateve gjate gjithe oreve te vitit. Nje hap i rendesishem pritet te realizohet edhe me projektin e rehabilitimit te vepres hidroteknik ne keto HEC-e e cila do te rrise ne nje shkalle te rendesishme sigurine ne pune te ketyre objekteve me rendesi te vecante.

Privatizimi i OSSH pritet te kete nje impakt te rendesishem pozitiv gjate periudhes rregullatore 2010 – 2014 ne rritjen e eficiences se konsumit te energjise elektrike me te pakten 21%, gje qe i sherben gjithashtu rritjes se sigurise se furnizimit te konsumatoreve me energji elektrike.

ERE shpreh bindjen se programi kompleks, i rritjes se sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike do te realizohet me sukses.

Pjesa e Dyte

1. Rregullimi ne sektorin e gazit natyror

1.1. Analize e Sektorit te Gazit Natyror ne Shqiperi, viti 2009

Strategjia Kombetare e Energjise ka percaktuar si nje nder prioritetet e sektorit energjetik zhvillimin e sektorit te gazit natyror per Shqiperine.

Prodhimi aktual i gazit natyror nga vendburimet vendase eshte ne nivele shume te uleta ne rreth 10 milion Nm³ dhe perdoret pothuaj plotesisht per nevojat e industrise se nxjerrjes dhe rafinimit te naftes. Per pasoje mundesite e furnizimit te vendit me gaz jane ose lidhja me rrjetet nderkombetare te gazit ose ndonje zbulim i mundshem nga kerkimet qe jane ende duke u zhvilluar ne vendin tone.

Furnizimi me gaz natyror i vendit tone eshte me interes sepse;

- balancon strukturen e burimeve alternative te furnizimit me energji dhe permireson kushtet e zhvillimit ekonomik te vendit.
- permireson sigurine e furnizimit me energji elektrike te vendit.
- permireson parametrat ekonomike te funksionimit te TEC Vlore dhe mundeson zgjerimin eventual te kapaciteteve te tij.
- ndertimi i burimeve te reja gjeneruese me gaz natyror krahas TEC-it te Vlores ndihmon ne reduktimin e humbjeve teknike ne sistemin energjetik shqiptar i cili deri me tani furnizohet pothuaj vetem prej HEC-eve kryesore ne veri te vendit.
- perdorimi i gazit natyror eshte energjia fosile me nivelin me te ulet te emisjoneve te CO₂ e per pasoje me e pranueshme nga ana mjedisore.

Eshte per tu patur ne konsiderate se gazi natyror eshte megjithate nje karburant i kushtueshem dhe per pasoje lidhja si konsumator fundor i vendit tone mundet te mos perbente alternativën me te leverdisshme per permiresimin e sigurise se furnizimit me energji.

Kuvendi i Shqiperise ka miratuar Ligjin Nr.9946, date 30.6.2008, "Per Sektorin e Gazit Natyror" i cili eshte pergatitur ne perputhje me Direktiven 2003/55/EC dhe Rregulloren 1775/2005 te Bashkimit European duke hedhur keshtu bazat per zhvillimin e sektorit te gazit natyror ne Shqiperi. Ligji eshte vleresuar si nje nga me te miret ne rajon e me tej.

Ndermjet te tjerash Ligji percakton dy role kryesore; Ministrine pergjegjese per energjine, METE, per te planifikuar dhe miratuar infrastrukturat e reja dhe Entin Rregullator te Energjise, ERE, per rregullimin e sektorit te gazit natyror. Bashkepunimi ndermjet ketyre institucioneve eshte i domosdoshem per perparimin e ketij sektori.

1.2. Zhvillimet ne sektorin e gazit natyror ne BE dhe ne rajonin Ballkanik dhe implikimet per vendin tone.

Gazi Natyror eshte aktualisht burimi i dyte me i rendesishem ne plotesimin e nevojave energjetike te BE me 24.6 % per vitin 2007 dhe sipas WEO¹ pritet qe te mbrije ne 28.5% te bilancit energjetik ne vitin 2030 . Per shkak te emisjoneve me te reduktura te CO₂, ne raport me energjite e tjera fosile, gazi natyror se bashku me energjite e rinovueshme do te kene rritje te vazhdueshme ne bilancin energjetik te BE.

¹ World Energy Outlook 2009.
Adresa:Rruga "Marsel Kashen"10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Prodhimi prej vendburimeve brenda BE qe mbulonte 42% te nevojave vetiake ne vitin 2005 eshte ne renie dhe parashikohet qe ne vitin 2030 te plotesoje vetem 11 % te nevojave.

Rusia eshte vendi me rezervat me te medha te provuara te gazit natyror ne glob dhe se bashku me Qatarin dhe Iranin kane me shume se gjysmen e rezervave boterore. Rusia eshte aktualisht furnizuesi me i madh i BE nderkohe qe po tregohet shume aktive ne shtrirjen e influencave te saja edhe ne burimet dhe infrastrukturat e tjera te gazit ne zonen e Kaspikut e me gjere. Keta faktore si dhe kriza e shkaktuar nga ndreperja e furnizimit me gaz natyror ne janar te vitit 2009 prej konfliktit Ruso-Ukrainas e kane sjelle ceshtjen e sigurise se furnizimit me gaz natyror te BE ne vemendje te shume analizave.

BE synon te beje diversifikimin e burimeve te furnizimit me gaz natyror duke identifikuar dhe mbeshtetur projekte te LNG dhe projekte te tubacioneve qe furnizojne BE me gaz natyror nga burime te tjera vec Rusise sic jane Afrika e Veriut, zona e detit Kaspik dhe Lindja e Mesme. Irani ndonese shume i pasur ne rezerva nuk eshte ende pjese e projekteve te qarta per shkaqe politike.

Projektet qe synojne te furnizojne BE me gaz prej zones se detit Kaspik dhe gaz rus dhe qe kalojne ne rajonin e Ballkanit jane;

- “NABUCCO” i cili eshte nje projekt prioritar i BE. Ai synon te sjelle gazin e zones se Kaspikut dhe gjurme e tij kalon ne zonen qendrore te Ballkanit. Te lidhur me kete projekt jane;
 - Interconnector Turkey-Greece-Italy. Lidhesi Turqi-Greqi-Itali i cili furnizohet me gaz prej NABUCCO dhe me tej mbasi furnizon tregun grek anashkalon Shqiperine nepermjet nje rruge me te gjate dhe ne thellesi me te medha detare per tu bashkuar me sistemin italian ne zonen e Barit.
 - TAP (Trans Adriatic Pipeline) eshte projekti i propozuar nga EGL dhe Statoil i cili synon te kaloje permes Shqiperise per tu bashkuar me rrjetin italian. Nje pjese e gazit pritet qe ne menyre te natyrshme te furnizojne edhe konsumatoret e tregut shqiptar.
- “South Stream” eshte nje projekt i promovuar prej Rusise si alternative e NABUCCO dhe konsiderohet shpesh si konkurent i ketij te fundit. Ky projekt ndonese ende i pazhvilluar ne detaje degezohet ne zonen e Ballkanit per te cuar nje pjese te gazit drejt Europes qendrore dhe nje pjese drejt jugut te Italise.

Ne figuren -4.1.- eshte paraqitur harta e projekteve te gazit “Nabucco” dhe “South Stream”




Figura 4.1.

Degezimi qe mendohet te kaloje drejt jugut te Italise duket se sikurse projekti ITGI (Intekonektori Turqi-Greqi-Itali) po e anashkalon Shqiperine pamvaresisht kostove me te larta qe ka nje trajektore e ketille.



Figura 4.2.

Ndonese Shqiperia eshte ne nje pozicion te favorshem gjeografik nepermjet te cilit kalojne rruget me te shkurtra per te lidhur vendburimet e zones se Lindjes se Mesme me jugun e Italise dhe me tej gjithe Europen perendimore, ajo tashme eshte anashkaluar nga IGTI i cili eshte ne nje faze me te avancuar se projektet e tjere, ndersa duket se e njejta gje po ndodh edhe me “South Stream”. I vetmi projekt i cili synon te kaloje nepermjet Shqiperise eshte TAP. Projekti TAP² ka

² <http://www.trans-adriatic-pipeline.com/> Trans Adriatic Pipeline Newsletter issue 2 Feb 2010

bere tashme identifikimin e gjurmës së mundshme të tubacionit sikurse edhe një vlerësim mjedisor dhe është në komunikim me METE për detajet e kontratës.

Alternativa të tjera të furnizimit të vendit tëone me gaz natyror;

- Ndertimi i një impjanti rigazifikimi të gazit të lëshuem LNG në bregdetin e qarkut Fier e propozuar prej kompanisë “Trans European Energy BV” sh.a. e cila me tej do të furnizojë tregun italian por duke kontribuar edhe për tregun shqiptar. METE është në ndjekje të marrvëshjes së mundshme.
- Lidhje fundore si zgjatime të sistemeve të Greqisë ose Maqedonisë. Të dy keto variante duhet të analizohen në detaje për leverdine e tyre ekonomike sikurse edhe për efektin e mundshëm dekurajues që mundet të luajne në projekte alternative potenciale për lidhjen e vendit me rrjetet nderkombetare të gazit natyror.
- Lidhjet në kuadrin e unazës së Komunitetit të Energjisë.

Shqipëria është Pale Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë e cila ka nënshkruar Traktatin përkatës së Athinës të datës 25 Tetor 2005 (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr.9501, datë 3. 4. 2006).

Ndertimi i një unaze të gazit natyror për vendet e Komunitetit të Energjisë është identifikuar si zgjidhje me e mire e cila do të jepte zgjidhje edhe disavantazheve që vijnë prej madhësisë modeste që kanë tregjet e vendeve të rajonit si dhe prapambetjes që trashëgon infrastruktura e sektorit të gazit. Pamvaresisht avantazheve që paraqet ai, progresi për dhenien jete këtij projekti ka qenë modest dhe konsiston kryesisht vetëm në ndertimin e TEC Vlore si një konsumator i rëndësishëm i gazit natyror në rajon. Kriza ekonomike ka dekurajuar ndermarjen e investimeve dhe tashme shikohet si më realiste një zbatim hap pas hapi i ndertimit të unazës kjo e influencuar edhe nga interesat individuale të vendeve të rajonit.

1.3. Arritjet e ERE në sektorin e gazit natyror gjatë vitit 2009 dhe sfidat për të ardhmen

Në përputhje me rolin e përcaktuar për të, në Ligjin për Gazin Natyror dhe atë për Energjinë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009 miratoi ndryshimet në Rregulloren e Praktikave dhe Procedurave të ERE për të përfshirë në të edhe aktivitetin e gazit natyror.

Me vendim të Kuvendit të Shqipërisë prej datës 9 shkurt 2009 Bordi i Komisionerëve të ERE u plotësua me një Komisioner të pestë i cili ka formimin e kërkuar për sektorin e gazit natyror.

Megjithatë pamvaresisht kërkesës së ERE për miratimin e ndryshimeve në struktura me personel shtesë një vendim i tillë nuk është marrë ende. Kjo ka sjellë vonësia në procesin e përgatitjes së akteve rregullatore dhe për më tepër vonësia në

formimin e personelit me njohurite e nevojshme qe kerkon rregullimi i ketij sektori. Ne perputhje me marrveshjen e nenshkruar ndermjet ERE dhe USAID per asistimin e ERE ne pergatitjen e kuadrit rregullator per sektorin e gazit natyror nen asistencen e konsulenteve te ofruar nga firma e kontraktuar per kete qellim nga USAID gjate vitit 2009;

- U mundesua pergatitja e “Rregullave dhe Procedurave per Dhenien, Modifikimin, Ripertitjen dhe Heqjen e Licensave ne Sektorin e Gazit Natyror”. Ky dokument mbas komenteve te bera edhe nga Sekretariati i Komunitetit te Energjise ne Vjene eshte tashme i plotesuar dhe do te kalohet per miratim prej Bordit te ERE.
- Eshte pergatitur projekti i “Rregullores se Trajtimit te Pranise se Paleve te Treta”. Edhe kjo Rregullore pritet qe gjate gjysmes se pare te vitit 2010 te jete e gatshme per tu miratuar nga Bordi i ERE.
- Jane pergatitur draftet e para te modeleve te licencave per nensektoret e Transmetimit, Gazit te Lengshem dhe Magazimimit.

Ne perputhje me programet e pergatitura puna e ERE per sektorin e gazit natyror po vazhdon edhe per;

- Analizen e Modeleve te mundshme te tregut per gazin natyror ne Shqiperi
- Zhvillimin e Metodologjise se Tarifave per sektorin e gazit natyror
- Vemendje e vecante ne aktivitetin e saj gjate vitit 2009 ERE i ka kushtuar bashkepunimit me rregullatoret analoge ne vendet e rajonit e me gjere. Ne kete kuader jane ndertuar bazat per bashkepunime dhe shkembime eksperiencash ne fushen e rregullimit te sektorit te gazit natyror me rregullatorin Italian, Turk, Grek, Kroat etj. Ne menyre te vecante shume frytdhense ka qene pjesmarrja aktive ne grupin e punes se gazit i ngritur ne kuadrin e Komunitetit te Energjise dhe lehtesuar prej Sekretariati te Vjenes si dhe pjesemarrja ne shume takime europiane dhe rajonale dedikuar ceshtjeve te gazit natyror.

Duke e vleresuar shume te rendesishem mundesimin e furnizmit te vendit me gaz natyror nepermjet alternativave me te favorshme ERE, Komisioneri per gazin ne ERE dhe personeli kane ndjekur me vemendje zhvillimet ne shkalle globale dhe rajonale dhe kane marre pjese ne aktivitetet qe kane te bejne me zhvillimin e ketij sektori.

Pjesa e Trete

III- Veprimtaria e Entit Rregullator te Energjise

1. Cmimet dhe tarifate e energjise elektrike per vitin 2010

Bazuar ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 per sektorin e energjise (i ndryshuar), perkatesisht ne nenet 26, 27 dhe 28 sidhe akteve te tjera qe burojne prej tij, ERE ushtron pergjegjesine ligjore per percaktimin e tarifave te aktiviteteve te rregulluara qe veprojne ne sektorin e energjise elektrike.

Ne kete kontekst nje nga veprimtarite kryesore te ERE-s gjate vitit 2009 ishte shqyrtimi i aplikimeve per cmime te reja nga ana e te licensuarve ne sektorin energjetik per aktivitetet e prodhimit dhe te aktiviteteve te furnizimit publik me shumice , transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice te energjise elektrike per konsumatoret tarifore.

Mbi bazen e nje analize te plote dhe te kujdesshme te treguesve teknike, ekonomike dhe financiare, te paraqitur nga kompanite ne mbeshtetje te kerkeses se tyre per te ardhura dhe permes nje procesi teper transparent ERE percaktoi tarifate dhe cmimet per aktivitetet e siperpermendura per vitin 2010 te cilet Bordi i Komisionereve te ERE-s i miratoi me Vendimet Nr.97,98,99,100 date 15.12.2009.

1.1 Metodologjite dhe procedurat e percaktimit te cmimeve e tarifave.

ERE ne mbeshtetje te akteve ligjore te sipercituara ka hartuar metodologjite per llogaritjen e tarifave te aktiviteteve te licensuara ne sektorin e energjise elektrike te cilat jane miratuar me vendimet Nr.76,77,78 dhe 79 date 26/06/2008 te Bordit te Komisionereve.

Nga ana tjeter per te garantuar nje proces transparent dhe te drejte te percaktimit te tarifave u zbatua me korrektesi Vendimi Nr.21 date 18.03.2009 i Bordit te Komisionerve te ERE-s mbi "Rregullat e praktikës dhe procedurave te ERE-s" i cili paraqet etapat permes te cilave duhej te kryhej procesi i aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit te tarifave te energjise elektrike.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe duke qene se tarifate e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per konsumatoret tarifore/fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te kater shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht pergjate gjithë procesit te ndjekur nga ERE.

1.1.1. Tarifa e prodhimit te energjise elektrike per KESH sh.a

Me 30 Shtator 2009, KESH sha. si i licensuar per prodhimin e energjise elektrike paraqiti ne Entin Rregullator te Energjise aplikimin per per rishikimin e tarifes se aktivitetit te prodhimit te energjise elektrike per vitin 2010.

Tarifa e propozuar nga ana e KESH/Gen per prodhimin e energjise elektrike per vitin 2010 ishte 1.11 leke /kWh, pra me nje rritje prej 41% nga tarifa e meparshme.

Llogaritja e tarifes se prodhimit te energjise elektrike eshte bazuar ne metodologjine e llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin nr. 77 ,date 26.06.2008 si dhe ne Deklaraten Rregullatore, te miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009;

Meqenese viti 2009 ishte nje vit, gjate te cilit nuk pati ndryshime ne tarifet dhe cmimet e energjise elektrike, ERE beri vleresimet perkatese per tarifen e prodhimit te energjise elektrike per KESH sh.a. duke marre per baze tarifen e miratuar ne vitin 2008.

Ne pergjithesi ERE i vleresoi te arsyeshme kerkesat e kompanise per te ardhura per vitin 2010, por i reduktoi ato per shumen prej 4,032 milion leke qe perfaqesojone te ardhura shtese qe kjo kompani realizoi nga eksportimi i energjise elektrike gjate vitit 2009, rregullim ky qe bazohet ne Modelin e Tregut te Energjise Elektrike, i cili percakton qe te ardhurat nga eksporti i energjise elektrike i perfitojne klientet tarifore. Ne kete menyre nga llogaritjet rezultoi nje tarife e prodhimit te energjise elektrike nga KESH/Gen prej 0.4 leke/kWh e cila shenon nje ulje prej 49% krahasuar me tarifen e meparshme prej 0.78 leke/kWh.

1.1.2. Tarifa e sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice.

Me 30 Shtator 2009, KESH sha. si i licensuar per furnizimin me shumice te energjise te energjise elektrike, paraqiti ne Entin Rregullator te Energjise aplikimin per rishikimin e tarifes se sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike per vitin 2010. me ane te cilit kerkoi rishikimin e tarifes nga 1.61 leke/kWh ne 2.78 leke/kWh me nje rritje prej rreth 72% per shkak te :

- Perfshirjes , per here te pare, te prodhimit te TEC –Vlore dhe si pasoje kostot e operimit qe e shoqerojne.
- Kostot e Overdrafteve te marra, nga institucionet e kreditit per vitin 2007 dhe 2008 per mbulimin e kostove per importimin e energjise elektrike per keto vite .
- Korigjimin e te ardhurave te periudhave te mepareshme rregullatore.

Llogaritja e tarifes se furnizimit me shumice te energjise elektrike eshte bazuar ne :

- Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike”;
- Deklaraten Rregullatore, te miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009;

Sa me siper, tarifa e sherbimit te shitjes me shumice te energjise elektrike, mbulon kostot e operimit per nje veprimtari normale si dhe koston e kredive te marra ne situata te veshtira likuiditeti, per pagesen e detyrimeve qe lidhen me faturat e importit te energjise elektrike, duke perjashtuar pagesat e principalit.

Pas analizave tekniko-ekonomike, seancave degjimore teknike dhe publike, tarifa e shitjes me shumice e energjise elektrike per FPSH per vitin 2010 u vendos 2.03 leke/kWh , pra me nje rritje prej 26% krahasuar me ate te periudhes se mepareshme rregullatore.

1.1.3. Cmimi i energjie elektrike per HEC-et egzistues deri ne 10 MW

Ne te njejten kohe me percaktimin e tarifave dhe çmimeve per sherbimet e energjise elektrike, lind detyrimi per te rishikuar çmimet e shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga prodhuesit e vegjel egzistues (koncesionare apo private) me fuqi te instaluar deri ne 10 MW si dhe te prodhuesve te rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW.

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et egzistues eshte zbatuar “Metodologjia per llogaritjen e cmimit te unifikuar per shitjen e energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW” aprovuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr.5, date 26.01.2007.

Bazuar ne llogaritjet e mesiperme çmimi i shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga te licensuarit koncesionare dhe private, me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, per periudhen 01 Janar 2010 – 31 Dhjetor 2010 u vendos 7.4 leke/kWh.

1.1.4. Cmimi i energjie elektrike per HEC-et e rinj deri 15 MW

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW eshte zbatuar ”Metodologjia per percaktimin e cmimit unik te energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW te dhene me koncension ne baze te Ligjit Nr. 9663, date 18.12.2006 “Per Koncensionet”.

Per te nxitur investimet per shfrytezimin e rezerves hidroenergjetike te

vendit, ne te gjitha rjedhat ujore, Qeveria adoptoi politiken e referimit nga cmimi i importit, te cmimit te shitjes se energjise elektrike, te prodhuar nga keto subjekte, te shoqeria publike KESH sh.a.

Sipas metodologjise se siperpermendur, per llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike eshte perdorur formula ne vijim;

$$P_u = P_i * 1.1. * R_{EX}$$

ku :

P_u eshte cmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW,

P_i eshte cmimi mesatar i importit te energjise elektrike te realizuar nga KESH sh.a. (ne funksionin e FPSH) ne vitin parardhes,

1.1 Koeficient, bonusu qe u jepet te licensuarve per nxitjen e prodhimit te energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW,

R_{EX} norma mesatare e shkembimit Leke/EUR te publikuar nga Banka e Shqiperise per vitin parardhes.

Duke zbatuar kete metodologji llogaritjeje cmimi i energjise elektrike nga HEC-et e rinj qe jepen me koncension me fuqi te instaluar deri ne 15 MW rezulton me 6.0 leke/kWh ose 23.3% me i ulet se cmimi per HEC-et egzistues me fuqi deri 10 MW (prej 7.4 leke/kWh) te cilet ndodhen ne shfrytezim.

ERE eshte e mendimit se nje dukuri e tille, qe vjen si rezultat i variacionit te cmimit te importit te energjise elektrike ne vite te ndryshem, nuk perputhet me politiken e Qeverise per nxitjen dhe inkurajimin e investimeve per ndertimin e ketyre hidrocentraleve. Ne keto kushte ERE i ka sygjerruar Qeverise qe nje gje e tille te rishikohet, gje qe eshte mare ne konsiderate nga ana e saj dhe po punohet per te percaktuar nje zgjidhje sa me te pershtateshme duke u mbeshtetur dhe ne pervojat e vendeve te tjera.

1.1.5. Tarifa e sherbimit te transmetimit te energjise elektrike

Operatori i Sistemit te Transmetimit i licensuar per aktivitetin e transmetimit te energjise elektrike paraqiti aplikimin per tarife te vitit 2010 prane ERE-s me date 30.09.2009, me ane te te cilit kerkoj rritjen e tarifes se sherbimit te transmetimit per vitin 2010 ne 0.8 lek/kWh ose ne masen 60% krahasuar me ate ekzistuese (0.5 leke /kWh).

Rritja e kerkeses per te ardhura per vitin 2010 nga ana e OST sh.a mbeshtetet ne kostot shtese te shlyerjeve te borxheve afatgjata qe lidhen me nje plan teper ambicioz investimesh, te cilat do ti sherbejne fuqizimit te rrjetit te transmetimit.

ERE ne llogaritjen e tarifes se transmetimit eshte mbeshtetur ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike, te miratuar me Vendimin

nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Mbas rishikimit dhe korigjimit ne zbritje te te ardhurave per vitin 2009 nga niveli i parashikuar, si rezultat i levrimit te nje sasise me te madhe energjie ne rrjetin e transmetimit nga eksporti i energjise, si dhe nje analize dhe vleresimi te te gjitha te dhenave teknike, ekonomiko-financiare te OST sh.a. dhe zbatimit te metodologjise perkatese tarifa e transmetimit per vitin 2010 u vendos 0.60 leke/kWh ose me nje rritje ndaj asaj egzistueses prej 20%.

1.1.6. Tarifa e sherbimit te shperndarjes dhe e furnizimit me pakice te energjise elektrike per konsumatorët fundore per vitin 2010

Shoqeria OSSH sh.a. ne funksionin e saj te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes si dhe te Furnizuesit Publik me Pakice paraqiti prane ERE-s me date 30.09.2009 aplikimin per tarifen e shperndarjes se energjise elektrike si dhe ate te furnizimit me pakice per konsumatorët tarifore per vitin 2010 . Aplikimi per tarifat e vitit 2010 nga ana e OSSH sh.a u krye ne kushtet kur kjo e fundit eshte e privatizuar

Ne aplikimin e saj OSSH sha per vitin 2010 kerkoi sa me poshte:

- Te ardhura per aktivitetin e shperndarjes dhe te furnizimit me pakice ne masen 43,602 milion leke duke mos parashikuar rritje te tarifes per aktivitetin e furnizimit me shumice (nga KESH-i) dhe te transmetimit (nga OST-ja).
- Nje kompesim te llogaritur nga OSSH sh.a per vitin 2009 (7,276 milion leke) dhe per tu rikuperuar ne vitin 2010 per 947 milion leke
- Cmimi mesatar me pakice per konsumatorët tarifore te percaktohej per 10.401 leke /kWh ose 44.2% me i larte se cmimi egzistues.

Shqyrtimi dhe miratimi i ketyre tarifave nga ana e ERE-s u bazua ne Vendimin Nr.79 date 26.06.2008 te Bordit te Komisionereve te ERE-s “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se shperndarjes se energjise elektrike”, ne Deklaraten Rregullatore te miratuar nga ERE me Vendimin Nr.12, date 03/03/2009 sidhe ne. Vendimin Nr.77 te Bordit te Komisionereve date 16.10.2009 “Per mosmiratimin e Auditit te Humbjeve”.

Sipas Deklarates Rregullatore OSSH-se i njihej e drejta te bente vleresimin e te ardhurave te munguara te vitit 2009 me ane te mekanizmit te kompensimit per tu reflektuar ne te ardhurat e perlllogaritura per vitin 2010.

Pas shqyrtimit te kujdesshem te kerkeses se OSSH sh.a., si dhe pas sqarimeve dhe informacionit shtese te dhene ne seancat teknike, u be vleresimi i kerkeses per

te ardhura te kompanise per vitin 2009 dhe parashikimi per vitin 2010.

ERE vendosi t'i njohe OSSH:

- te ardhura te arsyeshme per aktivitetin e shperndarjes dhe te furnizuesit publik me pakice 41,345 miljon leke per vitin 2010
- kompensim te llogaritur per vitin 2009 per t'u rikuperuar ne vitin 2010 per shumen 379 miljon leke .
- tarife te aktivitetit te shperndarjes 5.70 leke/kWh
Ne perfundim te analizave dhe metodologjise se perdorur cmimi mesatar me pakice per konsumatorët tarifore rezultoi 9.53 leke/kWh ose 13% rritje krahasuar me cmimin e miratuar nga ERE per vitin 2008.

Ky cmim mesatar shperndahet tek grupet e konsumatoreve tarifore sipas tabelës -6.1-

Sikurse shihet ne tabelen perfundimtare te cmimeve te percaktuara nga ERE ruhet edhe per vitin 2010 faturimi me blloqe konsumi per konsumatorët familjare duke respektuar te njejtin kufi prej 300 kWh per bllokun e pare dhe mbi 300 kWh per bllokun e dyte. Ne grafikun e figures -6.1.- eshte paraqitur struktura e tarifes per konsumatorët familjare. Analiza e kesaj strukture eshte kryer duke i siguruar OSSH-se te ardhurat e nevojshme nga klientet ne perputhje me bilancin financiar te parashikuar per vitin 2010.




Figura 6.1.

(Burimi ERE)

Tabela 6.1.

(Burimi ERE, OSSH)

Niveli i Tensionit	Kategorite e Konsumatoreve	Viti 2010			
		Nr. I konsumatoreve	Shitja GWh	Cmimi (leke/kWh)	Te ardhurat (milion leke)
TENSIONI I LARTE	Kliente te Transmetimit TL me asetete te zoteruar prej tyre				
	Industri	1	250	6.20	1,550
	Tregeti & sherbime				
	Bujqesi				
	Te tjere				
	Kliente te furnizuar ne N/S 110 kV te shperndarjes				
	Industri			8.00	
	Tregeti & sherbime			8.00	
TENSIONI I MESEM	Kliente te furnizuar ne 35 kV				
	Industri			8.50	
	Tregeti & sherbime	58	12	8.50	102
	Bujqesi			8.50	
	Te tjere			8.50	
				8.50	
	Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV				
	Industri	2,741	344	9.10	3,130
	Tregeti & sherbime	1,693	123	10.00	1,230
	Furra buke, prodhim mielli	88	14	7.10	99
	Bujqesi			8.70	-
	Te tjere	505	233	9.70	2,260
Buxhetore	271	44	11.50	506	
	5,298	758	9.53	7,226	
TENSIONI I ULET	Kliente te furnizuar ne TU				
	Industri	29	9	10.50	95
	Tregeti & sherbime	99,717	532	12.20	6,490
	Furra buke, prodhim mielli	2,155	38	7.60	289
	Bujqesi			10.50	-
	Te tjere	13,779	162	12.00	1,944
	Buxhetore	6,094	124	14.00	1,736
	Tarifa mesatare jo familjare	121,774	865	12.20	10,554
	Familjare	892,872	2,493	8.94	22,293
	Bloku I pare deri ne 300 kWh	755,089	1,959	7.70	15,084
	Bloku I dyte mbi 300 kWh	137,783	534	13.50	7,209
Mesatare Totale		4,378	9.5306	41,725	
Tarifa fikse e sherbimit per leximin "zero" (leke/muaj)			200		
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)			8.00		
Mesatare Totale		3,613	9.53	41724.90	

E rendesishme eshte te theksohet se kjo strukture cmimi e konsumatoreve familjare dekurajon perdorimin e energjise elektrike per ngrohje te mjedisit, mbasi sikurse eshte vertetuar nga nje sere studimesh, konsumi i energjise elektrike per ngrohje fillon ne nivelin e konsumit mbi 300 kWh ne muaj. Egzistojne te gjitha mundesite qe ngrohja e mjedisit te realizohet me lende te tjera energjetike alternative. Me interes eshte gjithashtu fakti se 71 % e konsumatoreve familjar shpenzojne me pak se 300 kWh/muaj.




Figura 6.2.

(Burimi ERE,OSSH)

Ne grafikun e figures -6.2.- eshte paraqitur struktura e shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2008. Sikurse vihet re 67% te kostove i perkasin OSSH-se, nga te cilat 45% jane kosto te humbjeve te energjise dhe 19% kosto te borxhit




Figura 6.3.

(Burimi ERE,OSSH)

Ne grafikun e figures -6.3.- eshte paraqitur struktura e shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2010. Sikurse vihet re 67% te kostove i perkasin OSSH-se, nga te cilat 28% jane kosto te humbjeve te energjise dhe 11% kosto te borxhit tekeq

Per te pasur nje transformim te shpejte te gjendjes, persa i perket rritjes se eficiences se konsumit te energjise elektrike e gjithë vemendja duhet te perqendrohet ne permiresimin me ritme te larta te situates ne OSSH, mbasi ky ka qene edhe nje nga qellimet kryesore te privatizimit te kesaj shoqerie.




Figura 6.4.

(Burimi ERE, OSSH)

Ne grafikun e figures -6.4.- eshte paraqitur ecuria e cmimeve te energjise elektrike Gjate periudhes 2005-2009, ku shume domethenes eshte fakti qe cmimet konsumatoreve jo familjar u ulen me 18% per te kaluar keshtu ne tendencat e sotme perendimore ku cmimet per jo familjaret jane me te ulta se ato te familjareve.

1.2. Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike ne tregun rajonal, viti 2009

Ne grafikun e figures -6.5.- jane paraqitur cmimet mesatare te energjise elektrike perpara dhe mbas taksimit, ne vendet antare te ERRRA-s per vitin 2008.

Tipar karakteristik i ketij grafiku eshte dukurija qe vendet e ish B.S. kane tarifa shume te ulta te energjise elektrike, kurse vendet antare te BE-se keto tarifa i kane mjaft me te larta ne krahasim me to. Nje dallim i tille buron nga fakti i egzistences se burimeve te pasura hidrokarbure ne keto vende por dhe i trashegimise politike te nje sistemi shoqeror krejtesisht shteteror dhe i politikave populiste te ndjekura ne keto vende.

Ne krahasim me vendet e rajonit vendi yne renditet ndermjet tyre mbasi ne reformen e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike metodologjite tona mbeshteten ne mbulimin e kostove te seicilit sherbim.




Figura 6.5.

(Burimi ERA,)

Ne se efienca e konsumit te enrgjise elektrike ne vendin tone do te ishte me e mire, cka nenkupton se humbjet e energjise elektrike, teknike dhe jo teknike, do te ishin brenda standarteve te kerkuara, atehere si pasoje e prodhimit me kosto me te ulet te energjise elektrike nga burimet hidro, edhe cmimet e energjise elektrike do te ishin me te ulta.

1.3. Cmimet dhe tarifate e energjise elektrike ne tregun e BE-se, viti 2009

Karakteristike e sistemit tarifor per konsumatorët fundor ne vendet e BE-se Eshte adoptimi i nje strukture tarifore te mbeshtetur ne 6 blloqe konsumi per konsumatorët industriale dhe ne 5 blloqe konsumi per konsumatorët familjare. Blloqet jane te ndertuar sipas konsumit vjetor ne kufijt qe paraqiten ne tabelen - -

Tipi i Konsumatorit	Konsumi vjetor i energjise elektrike ne MWh/Vit					
	< 20	20 - 500	500 – 2,000	2,000 - 20,000	20,000 - 70,000	70,000 - 150,000
Industriale	< 20	20 - 500	500 – 2,000	2,000 - 20,000	20,000 - 70,000	70,000 - 150,000
Familjare	< 1.0	1.0 – 2.5	2.5 - 5	5 – 15	>15	--

Tabela -6.2 -

(Burimi Rreg. Italian)

Ne grafikun e figures -6.6.- jane paraqitur tarifate e energjise elektrike para dhe pas taksimit (TVSH-se)per konsumatorët jo familjare, per te gjitha vendet e BE-se, ne cent euro/kWh dhe ne lek/kWh (duke ju referuar kursit te kembimit

1Euro = 130 leke) per nje konsum mujor 41,000 – 164,000 kWh. Cmimi mesatar i energjise elektrike si BE per konsumatoret industrial ne kete bllok konsumi eshte 12.97 centEuro/KWh (ose 16.86 Lek/kWh).

CMIMET E ENERGJISE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET JO-FAMILJAR TE VENDEVE TE BE-se, Viti 2009 (Per nje konsum mujor 41000 - 164000 kWh)




Figura 6.6. (Burimi Rregullatori Italian.)

Ne grafikun e figures 6.7. jane paraqitur cmimet e energjise elektrike per konsumatoret familjar per nje konsum mujor 200-400 kWh. Ne kete rast cmimi mesatar i energjise elektrike si BE rezulton 16.91 Euro cent/kWh (ose 21.98 Lek/kWh).

CMIMET E ENERGJISE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET FAMILJAR TE VENDEVE TE BE-se, VITI 2009 (Per nje konsum mujor 200 - 400 kWh)




Figura 6.7. (Burimi Rregullatori Italian.)

Cmimi i konsumatoreve familjar ndaj cmimit te konsumatoreve industrial ne blloqet respektive rezulton 69.5% me i larte. Ky eshte nje parim me rendesi ne politiken e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, mbasi synon te

inkurajoje veprimtarine prodhuese e cila per pasoje sjell rritjen e te ardhures kombetare.

Cmimet me te larta te energjise elektrike ne vendet e BE-se i ka Danimarka ndersa me te ultat i ka Bullgaria. Cmimet e vendit tone nuk jane me te ultat e vendeve te BE-se, por nder me te ultat, ndonse te ardhurat per fryme jane me te ultat, faktori themelor i kesaj renditjeje eshte efienca e ulet e konsumit te energjise elektrike ne sistemin e shperndarjes.

2. Licensimi i veprimtarive ne Tregun e Energjise Elektrike

Gjate vitit 2009 Sektori i Licensimit ne Drejtorine e Licensave dhe Monitorimit te Tregut ka ndjekur dhe trajtuar 26 aplikime per:

- licensim ne aktivitetet e sektorit te energjise elektrike;
- modifikimin e licensave ekzistuese;
- rinovimin e licensave
- kualifikimin e impianteve si prodhues te energjise se rinovueshme.

Prej ketyre, per 6 aplikime procesi u finalizua ne fund te muajit janar dhe fillim te muajit shkurt 2010 , ndersa 2 aplikime te tjetra jane ende ne proces dhe pritet te mbyllet brenda muajit shkurt 2010.

Edhe kete vit pjesa me e madhe e aplikimeve eshte paraqitur nga subjekte nenshkruese te marveshjeve te koncesionit me Qeverine Shqiptare te cilat me pas paraqiten ne ERE per tu licensuar ne prodhimin e energjise elektrike. Pavec sa me siper si aplikime me teper rendesi per sektorin ishin dhe aplikimet e paraqitura nga subjektet KESH sha dhe OST sha per rinovimin e licensave perkatese ne prodhimin, tregtimin dhe transmetimin e energjise elektrike.

Tabela 6.3.

(Burimi Rregullatori Italian,)

Aktiviteti	Nr. i licensave te miratuara
Prodhim	5
Furnizues i Kualifikuar	1
Tregtimi	4
Modifikim i licensave ekzistuese	3
Rinovim	3
Kualifikim i impianteve si burime te rinovueshme energjie	2

Ne tabelen -6.3.- ne menyre te permbledhur paraqiten licensat e miratuara nga ERE gjate vitit 2010 sipas llojit te aktivitetit.

2.1. Licensimi per prodhimin e energjise elektrike

Sic u permend me lart nje pjese e konsiderueshme e licensave te leshuara nga ERE gjate vitit 2009 i perkasin aktivitetit te prodhimit te energjise elektrike. E vecanta e ketij aktiviteti qendron se ne te jane perfshire nje numer i konsiderueshem subjektesh private i cili rritet vit pas viti.

Tabela 6.4.

(Burimi ERE,)

Emri i shoqerise	Vend-ndodhja	Kapaciteti i instaluar (MW)	Prodhimi vjetor (GWh)	Investimi (milion €)
TEC-i Vlore sha	Vlore	97	700	82
HEC-i Pure Energy Stebleva shpk	Librazhd	3.4	12.6	1.15
HEC-i Malido Energji shpk	Mirdite	1.95	5.13	0.7
HEC-i Teodori 2003 shpk	Bulqize	13.7	82	17.14
Energji Ashta Shpk	Shkoder	48.2	230	140.35

Aktualisht jane 19 subjekte te licensuara per prodhimin e energjise elektrike pa perfshire ketu shoqerine KESH sha dhe Tremocentrali Vlore sha si dhe 12 subjekte te tjera te licensuara ne ndertimin e impjanteve te reja gjeneruese te cilat bashke me licensen per ndertimin e impinteve gjeneruese kane marre dhe licensen per prodhimin e energjise elektrike.

Ne tabelen -6.4.- ne menyre te permbledhur jane paraqitur te dhenat kryesore per sa i perket fuqise se instaluar, prodhimit te energjise dhe vleres se investimit per subjektet e licensura ne prodhimin e energjise elektrike.

Per sa i perket operimit te subjekteve te mesiperme nga informacioni i disponuar nga ERE rezulton se shoqeria Pure Energy Stebleva shpk e licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga HEC Stebleva sapo ka nisur punimet per ndertimin e vepres.

Per sa i perket shoqerise Malido Energji shpk e licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga HEC Klos, rezulton se ky subjekt ka perfundur procesin e marrjes se te gjitha lejeve te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit, jane porositur makinerite dhe paisjet (turbine, gjeneratori, paneli komandimit etj.) dhe pritet levrimi nga prodhuesi i tyre. Shoqeria ka kryer njekohesisht edhe nje volum te

rendesishem punimesh hidroteknike dhe parashikohet qe ne muajin korrik 2010 hidrocentrali te vihet ne pune.

Shoqeria Teodori 2003 shpk, e licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga HEC Zall Bulqizes dhe Ternove ka siguruar financimin e projektit nga banka,

eshte avancuar ne kryerjen e punimeve hidroteknike per sa i perket realizimit te digave dhe baseneve ne masen 40% dhe brenda nje periudhe 15 mujore parashikohet te perfundojne te dy objektet dhe te futen ne shfrytezim.

2.2. Licensimi per tregtimin e energjise elektrike

Tregtimi i energjise elektrike perben nje nga aktivitetet e sektorit te energjise elektrike ne te cilin subjektet private jane te perfshire me teper pas atij te prodhimit te energjise elektrike. Fillimisht kuadri ligjor percaktonte autoritetin e ERE per te licensuar subjektet e interesuara ne aktivitetin e importit dhe eksportit te energjise elektrike. Me amendimin e Ligjit Nr. 9072, dt.22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" i ndryshuar, si dhe me miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike dhe te Rregullave te Tregut te Energjise Elektrike u prezantua koncepti i tregtuesit dhe tregtimit te energjise elektrike.

Ne perputhje me keto dokumenta tregtimi dhe tregtuesi i energjise elektrike perkufizohet si person i licensuar qe blen dhe shet energji elektrike, me perjashtim te shitjes tek furnizuesi publik me pakice dhe te klientet fundore. Jane subjekte private vendase ose te huaja, qe blejne dhe shesin energji elektrike me shumice.

Gjate vitit 2009 ERE licensoi kater subjekte te tjere ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike dhe rinovoi licensen e tregtimit per nje subjekt (KESH sha) duke bere qe numri i te licensuarve ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike te arrije ne nente te licensuar deri ne fund te vitit 2009. Aktiviteti i tregtimit te energjise elektrike se bashku me ate te furnizimit te klienteve te kualifikuar kane qene ne vemendjen te subjekteve private duke bere qe ne nje periudhe prej me pak se dy vjetesh te licensohen 15 subjekte private ne keto dy aktivite. Tashme mund te themi qe ekzistojne kushtet per nje liberalizim te metejshe te tregut te energjise elektrike duke qene se ekzistojne te licensuarit dhe ekziston hapsira e nevojshme per konsumatorin per te marre statusin e klienteve te kualifikuar pavaresisht nese jane kliente familjare apo jo dhe pavaresisht nivelit te konsumit vjetor te energjise elektrike.

Ne tabelen -6.5. - ne menyre te permbledhur subjektet e licensuara ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike

Tabela 6.5.

(Burimi ERE,)

Nr	Subjekti	Tipi i Licenses	Vendimi i ERE	Vlefshmeria deri me:
01	GSA shpk	Tregtim	Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008	26/01/2011
02	Spahiu Gjanc shp.k	Tregtim	Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008	07/06/2010

03	UNIVERSI shpk	Tregtim	Vendimi nr.113 dt. 24/09/2008	24/09/2013
04	Gen I Tirana shpk	Tregtim	Vendimi nr.130 dt 02/12/2008	02/12/2013
05	Enpower Albania	Tregtim	Vendimi nr.08 dt 04/02/2009	20/02/2039
06	KESH sha	Tregtim	Vendimi nr. 23 dt. 25/03/2009	25/03/2014
07	Wonder Power sha	Tregtim	Vendimi nr. 34 dt. 07/05/2009	18/12/2033
08	EFT Albania shpk	Tregtim	Vendim nr.53 dt 03/08/2009	02/08/2014
09	EGL Albania sha	Tregtim	Vendim nr.92 dt 08/12/2009	07/12/2014
10	CEZ Trade Albania shpk	Tregtim	Vendimi nr.1 dt.20/01/2010	19/01/2015

2.1. Certifikimi i energjive te rinovueshme

Nje nder aktivitetet qe mbulon Sektori i Licensimit eshte dhe ai per kualifikimin dhe certifikimin e energjise se rinovueshme. Sic dihet deri me sot ERE ka licensuar nje numer te madh subjektesh ne prodhimin e energjise elektrike si nga HEC-et ashtu dhe nga burime te tjera te energjise se rinovueshme sic jane parqet eolike apo centralet me biomase.

Tabela 6.6.

(Burimi ERE,)

Emri i Kompanise	Tipi i centralit	Vendi ndertimit	Fuqia e instaluar MW	Prodhimi vjetror GWh	Investimi Milion Euro
Alb Wind Energy shpk	Park eolik	Kryevidh, Terpan	225		
Running Energy shpk	Park Eolik	Durres	27.6		

Gjate vitit 2009 ne ERE jane paraqitur vetem dy kerkesa per kualifikimin e impianteve prodhuese si burime te rinovueshme energjie te cilat paraqiten ne tabelen -6.6.-.

Kualifikimi i dy subjekteve te mesiperme e ka bere qe numri total i subjekteve te kualifikuara te arrije ne 8 (6 parqe eolike, nje TEC me biomase dhe nje HEC) me fuqi te instaluar ne total rreth 1530 MW.

Per sa i perket pergjegjesive te ERE ne procesin e kualifikimit dhe certifikimit te energjive te rinovueshme duhet permendur dhe ndryshimet me te fundit ne kuadrin ligjor me Ligjin Nr. 10196 dt.10.12.2009 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.9072, dt.22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" i ndryshuar".

Keto ndryshime kane percaktuar ERE si autoritet kompetent per zbatimin e ketij procesi si dhe hartimin dhe miratimin e kudrit ligjor sekondar te nevojshem duke krijuar hapsiren per te perfshire ne rregulloren qe aplikon ERE per procesin e

kulifikimit dhe certifikimit te prodhimit te energjise elektrike nga burime te rinovueshme, detaje te cilat lidhen me perpuethshmerine e procedurave qe aplikohen ne Republiken e Shqiperise me procedurat qe aplikohen ne vende te tjera me te cilat mund te nenshkruhen marreveshje per njohjen reciproke te tyre.

3. Monitorimi i tregut te energjise elektrike

Ne zbatim te ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neni 8, pika 2 gërmat f) dhe g) si dhe neni 63. E.R.E ka autoritetin dhe detyrimin për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatoreve të licensuar në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, kushteve të kontratës si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhërave të E.R.E-s.

Procesi i monitorimit eshte institucionalizuar tashme qe ne qershorin e vitit 2008 per veprimtarine e monitorimit te tregut dhe te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike nepermjet krijimit te strukturave te specializuara monitoruese.

3.1. Parimet e Monitorimit te tregut te energjise elektrike

Monitorimi i te licensuarve ne tregun e energjise elektrike eshte realizuar gjate gjithë vitit 2009 ku pervec strukturave te specializuara jane angazhuar edhe specialiste nga strukturat e tjera perberese perberese te ERE-s .

Monitorimet jane kryer bazuar ne plane tematike paraprake dhe organizuar ne menyre te tille qe te kontrollohen ne vazhdimesi rezultatet e pjesmarresve te tregut te energjise elektrike.

Procesi i monitorimit eshte kryer duke ndjekur periodikisht hapat e me poshtme:

- Mbledhja dhe perpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve .
- Perpunimi i rezultateve dhe percaktimi i vlerave te indikatorëve te performances
- Raportim i analizes se treguesve te performances se pjesmarresve te tregut te energjise prane Bordit te Komisionereve te ERE-s.
- Diskutim i zgjeruar i problematikave ne mbledhjet periodike te Bordit te Komisionereve.
- Percaktimi i qendrimit te ERE-s lidhur me performancen e operatoreve si dhe pergatitja e qendrimëve dhe rekomandimeve per to.
- Identifikimi i ceshtjeve per monitorim tematik ne terren
- Kryerja e monitorimeve ne terren dhe analizim i rezultateve.

- Percaktim i qendrimit dhe rekomandimeve te ERE-s lidhur me gjetjet nga monitorimet.

Gjate vitit 2009 monitorimi ka konsistuar kryesisht ne veprimtarite e shoqerive publike te sektorit elektroenergetik. Si rezultat i monitorimit te vazdueshem dhe atij tematik ne terren, ne perfundim te vitit 2009, per keta Operatore te tregut te energjise elektrike paraqiten ne vijim problematikat qe jane konstatuar dhe qe kerkojne nje trajtim specifik gjate vitit 2010.

3.2 Monitorimi i KESH-Gjenerimit

Rezultatet e KESH-Gjenerimit jane monitoruar nepermjet perpunimit te raporteve periodike, informacioneve nga OST e OSSH si dhe nga informacione apo ankimime te ardhura nga burime te ndryshme. Gjithashtu jane ndermarre monitorime tematike me grupe pune lidhur me rregullshmerine e realizimit te importeve e eksporteve. Pas analizimit te rezultateve ne Bordin e Komisionereve te ERE-s jane pergatitur rekomandime dhe qendrimet lidhur me qellim permiresimin e performances.

Problemet kryesore ku eshte e nevojshme te permiresohet me tej gjendja ne kete shoqeri gjate vitit 2010 konsistojne ne:

- Maksimizimi i eficences se perdorimit te rezerves hidroenergetike ne hidrocentralet e KESH-Gen, duke konsoliduar strukturat dhe permiresuar procedurat egzistuese, pa cenuar shkallen e sigurise se veprave hidroteknike dhe duke shmangur ne maksimum mundesite e permbytjeve ne zonen e shkarkimit te plotave.
- Permiresimi i mardhenieve institucionale me operatorin e Sistemit te Transmetimit dhe Shperndarjes duke mundesuar nje parashikim sa me te sakte te nevojave ditore, javore, mujore e vjetore ne zbatim te Rregullave te Tregut.
- Zbatimi me rigorozitet i procedurave te parashikuara ne Rregulloren e Shitjeve dhe ate te Shkembimeve te importit, eksportit dhe shkembimit si dhe institucionalizimi i praktikave me studime parashikuese per shfrytezim maksimal te tregut rajonal.
- Venia ne eficence e TEC-it Vlore ne parametrat e parashikuar dhe maksimizimi i efektivitetit te shfrytezimit tij.

3.3 Monitorimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit

Monitorimi i OST-se eshte kryer periodikisht duke ndjekur jo vetem raportimet mujore por edhe ato ditore me qellim informimin e vazhdueshem te Bordit te Komisionereve te ERE-s dhe njohjen e vazhdueshme te situates

energjitike ne vend. Jane kryer edhe monitorime tematike sic eshte ai i defektit ne sistemin e transmetimit te dates 13.02.2009 me qellim evidentimin e kapaciteteve

organizative dhe teknike per perballimin e situatave emergjente ne sistemin e transmetimit.

Ne fokus te vemendjes edhe per vitin 2010 do te mbeten krahas te tjerave:

- Maksimizimi i sigurise se furnizimit e shfrytezimi maksimal i kapaciteteve transmetuese
- Zbatimi rigoroz i planit te riparimeve apo remonteve duke minimizuar nderprerjet.
- Zbatim i planit te investimeve per rritjen e kapaciteteve egzistuese.

3.4. Monitorimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes

Monitorimi i OSSH-se ka zene volumin me te madh ne punen monitoruese pasi edhe problematikat jane me te mprehta dhe me efekte direkte ndaj konsumatoreve. Pavec analizimit periodik mujor te performances se OSSH-se ne teresi dhe zonave te saj ne vecanti, jane ndermarre monitorime specifike ne zonat Tirane, Kukes, Elbasan, Vlore etj, per ato ceshtje qe jane gjykuar si me problematiket ne periudhen para privatizimit te OSSH-se. Ne fokus te monitorimeve tematike kane qene humbjete energjise, plotesimi me matsa, sistemi i faturimit, arketimet, detyrimet e pa arketuara, permiresimi i bazes se te dhenave per cdo klient, cilesia e raportimeve etj. Bordi i komisionereve eshte informuar periodikisht dhe jane pergatitur rekomandime e qendrime me qellim permiresimin e treguesve te performances.

Edhe pas privatizimit monitorimi ka vazhduar normalisht dhe ne menyre specifike eshte perqendruar ne ato tregues qe permenden edhe ne Deklaraten Rregullatore. Vlen te permendet ndjekja dhe analizimi i te dhenave per humbjete teknike e jo teknike.

Pritshmeria per permiresimin e treguesve te performances se OSSH eshte e madhe nga ana e qeverise dhe konsumatoreve te energjise elektrike dhe si rrjedhim ERE ndjehet e obliguar te monitoroje nga afer ecurine me qellim garantimin e permiresimit te situates. Ceshtjet kryesore qe mbeten per tu monitoruar gjate vitit 2010 jane:

- Arritja e objektivave te percaktuara ne Deklaraten Rregullatore.
- Zbatimi i Planit te Investimeve.
- Perfundimi i Sistemit te Faturimit ne parametra bashkekohore.
- Perfundim i studimit te Humbjeve Teknike ne sistemin e shperndarjes.
- Percaktimi dhe zbatimi i treguesve te Cilesise se Sherbimit.
- Plotesimi me matje i te gjithe klienteve dhe eliminimi i faturimit aforfe.
- Zbatimi i Rregullave te Tregut.
- Zbatimi i Kodit te Shperndarjes
- Zbatimi i Kodit te Matjes.

ERE e konsiderone suksesin e veprimtarise se OSSH-se ne manaxhimin e

veprimtarise se shperndarjes te energjise elektrike si faktorin themelor ne suksesin e pergjithshem te sektorit te energjise elektrike ne Shqiperi, dhe duke qen keshtu do te jete shume bashkepunuese dhe e hapur per te gjetur rruget e duhura, te mbeshtetura ne ligj, ne menyre qe te arrihet nje transformim i rendesishem pozitiv ne kete sektor.

4. Veprimtaria e ERE-s per hartimin dhe perpunimin e legjislacionit sekondar

Gjate vitit 2009 ne sektorin e energjise elektrike jane nxjerre nje sere aktesh ligjore si nga ana e ERE-s, ashtu edhe nga institucionet e tjera ne autortietin e te cileve jane cheshjte te caktuara te sektorit te energjise elektrike te cilat ne vijim jane grupuar ne:

- Aktet nenligjore te miratuara nga ERE;
- Ndryshime ne legjislacionin primar te sektorit te energjise elektrike;
- Akte nenligjore te miratuara nga Keshilli i Ministrave.

4.1. Aktet nenligjore te miratuara nga ERE gjate vitit 2009

Ne perputhje me pergjegjesite e percaktuara ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", te ndryshuar, Modelin e Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me VKM nr.338 date 19.03.2008, te ndryshuar, ERE ka miratuar gjate vitit 2009 nje sere aktesh nenligjore. Ne hartimin dhe miratimin e ketyre dokumentave ERE sikuresedhe gjate viteve te tjera ka ndjekur nje parim te rendesishem te punes se saj ate te aksesit te paleve te interesuara dhe transparences per publikun. Rregullisht ne perputhje me Rregullat e Praktikës dhe porceudrave te saj, ERE ka zhvilluar seanca degjimore me palet e interesuara si dhe ka bere njoftime publike mbi aktet nenligjore qe miratohen nga ERE. Qellimi i ketyre seancave degjimore dhe njoftimeve publike ka qene marrja e komenteve te mundshme nga palet e interesuara me qellim qe para miratimit te aktit te analizoheshin edhe kerkesat e paleve qe prekeshin nga rregullimi i aktit nenligjor te ERE-s.

- **Rregullat dhe Procedurat e Shitjes se Energjise Elektrike**

Ne fillim te muajit Janar ERE rishikoi Rregullat e Shitjes se Energjise Elektrike, te miratuara me vendimin nr.1, date 09.01.2009 e te publikuara ne Fletoren Zyrtare nr.4 date 09.01.2009. Per rishikimin e ketyre rregullave sherbyen si pikenisje ndryshimet e dates 24 Dhjetor ne Modelin e Tregut te

Energjise elektrike, te cilat sanksionuan se shitja e energjise elektrike nga KESH sh.a nuk lidhet vetem me energjine e prodhuar per shkak te pllotave te

medha. Ne kete aspekt ne rregulloren per procedurat e shitjes se energjise u reflektua ky ndryshim si dhe ndryshime te tjera te cilat pergjithesisht kane konsistuar ne:

- Perpunimin e nenit 4, i cili ka te beje me identifikimin e pergjegjesise se autoritetit shites per percaktimin ne sasi dhe kapacitet te energjise elektrike qe shitet, ne te cilin eshte perpunuar dispozita duke sanksionuar se percaktimi i sasise, kapacitetit, periudhes kohore dhe programi i livrimit do te bazohet mbi perodrimin e burimeve energjitike sipas planifikimit te kryer ne perputhje me percaktimet e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, Rregullave te Tregut te Energjise dhe Kodit te Rrjetit.
- Perpunim i dispozitave te nenit 5 qe lidhen me kryerjen e shitjes se energjise elektrike per efekt te transaksionit financiar fitimprures, duke evidentuar se ky transaksion do te behet per sasine e energjise elektrike pas plotesimit te nevojave te OST sh.a dhe Klienteve tarifore.

- **Rregullore per Kriteret e Dhenies dhe Heqjes se Statusit te Klientit te Kualifikuar**

Me vendimin nr.17, date 06.03.2009, te botuar ne Fletoren zyrtare nr. 41, date 09.04.2009, ERE rishikoi Rregullat per kriteret e dhenies dhe heqjes se statusit te Klientit te Kualifikuar. Rishikimi i kesaj rregulloreje mori ne konsiderate percaktimet e Traktatit te Komunitetit te Energjise, dhe ne menyre te vecante te pjeses qe lidhet me percaktimin e pikes 3, te Shtojces "A", ku thuhet se: *Secila Pale Kontraktuese duhet te sigurohet qe kliente te kualifikuar brenda kuadrit te Direktivave te Komunitetit European 2003/54/EC dhe 2003/55/EC do te jene:*

- i) Nga 1 janari 2008, te gjithë konsumatorët jofamiljarë;
- ii) nga 1 janari 2015 te gjithë konsumatorët.

Ne kete rregullore, ne kuader te traktatit te sieprcitur, dhenia e statusit te Klientit te Kualifikuar nuk lidhet me vendin e konsumit apo nivelin e konsumit te energjise nga konsumatorët, sikurse parashikohej me pare.

- **Deklarata Rregullatore**

Deklarata Rregullatore eshte nje akt me mjaft rendesi i procesit te privatizimit. Ky dokument u miratua nga Bordi i Komisionereve me Vendimin nr.12, date 03.03.2009 i cili u botua ne Fletoren Zyrtare nr.40 date 04.04.2009,

Deklarata Rregullatore percakton nje periudhe rregullimi 2009 -2014 dhe permban detjaje te rendesishme, si percaktimi i nivelit te humbjeve per periudhen e pare te rregullimit dhe objektivat per periudhat ne vijim, gjithashtu ne deklarate vendosen edhe indikator te tjere te rendesishem te tille si niveli i borxhit te keq dhe objektivi per uljen e borxhit te keq, normen e fitimit per kompanine etj. Te gjithë keto elemente jane indikator te rendesishem per percaktimin e cmimieve te energjise elektrike.

- **Rregullore per Procedurat e Rregjistrimit ne Tregun e Energjise Elektrike**

Ne kuader te zbatimit dhe implementimit te Rregullave te Tregut te miratuara nga ERE, me Vendimin nr.40 date 18.05.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.92 date 18.06. 2009, u miratuan Rregullat per Procedurat e Rregjistrimit ne Tregun e Energjise Elektrike. Nepermjet ketyre rregullave percaktoheshin procedurat dhe dokumentacioni qe cdo aplikues paraqet prane OST sh.a per t`u bere Pjesmarres ne Tregun e Energjise Elektrike. Po ashtu rregullorja vendos afatet per kohen e verifikimit te te dhenave te aplikimit nga OST sh.a, si dhe afati per kohen e njoftimit te aplikuesit nga OST sh.a, per pranimin ose jo te aplikimit. Rregullorja vendos dispozita lidhur me rastet e mosaprovimit te aplikimit nga OST sh.a, trajtimit te kerkesave per terheqje, pezullim dhe perfundim te pjesmmarrjes ne treg.

- **Ndryshime ne Kodin e Funkcionimit te Rrejtit**

Me vendimin e Bordit te Komisionereve nr.38 date 18.05.2009 te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.92, date 18.06.2009, ERE vendosi te beje disa ndryshime dhe shitesa ne Kodin e Funkcionimit te Rrejtit. Keto ndryshime u ndermoren me qellim per t`i hapur rrugen teknologjive te reja, ne kuadrin e nxitjes se inisiativave private, sigurimit te funksionimit eficient te tregut te energjise elektrike, nepermjet zhvillimit te konkurrences ne kete sektor, me qellim mbrojtjen e interesave te konsumatoreve dhe minimizimin e koston se sherbimit me energji elektrike, duke perdorur njesite Straflomatrix me gjenerator me magnet permanent, dhe konkretisht ndertimit te HEC "Ashta1" dhe HEC "Ashta2", projekte keto te miratuara me Marreveshjen e Koncesionit te dates 30 Shtatot 2008, ndermjet

shoqerise koncesionare dhe METE-s per ndertimin, pronesine, shfrytezimin, mirembajtjen dhe transferimin e projektit te nje hidrocentrali te ri ne Ashte.

- **Ndryshime ne Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike**

Nisur nga problematika e hasur nga OST sh.a gjate zbatimit ne praktike te Rregullave te Tregut, ERE vendsoi te beje disa ndryshime ne keto rregulla. Nepermjet ketyre ndryshimeve u riperpunuan rregullat ne lidhje me aspekte te tranzitimit, ne menyre te tille qe kerkesat per kapacitet interkonjeksioni per qellime tranzitimi do te merren ne konsiderate nga ana e OST sh.a, vetem mbas plotesimit te kerkesave per importin e energjise elektrike per nevojat e konsumatoreve tarifore. Po ashtu ndryshime pesuan edhe dispozitat ne lidhje me alokimin e kapaciteteve te interkoneksionit ne drejtim te eksportit dhe importeve duke bere qe keto ndryshime dhe shtesa pervec nevojës se praktikës ne vend t'i sherbejne edhe perafimit me legjislacionin e BE-se.

- **Rregullat dhe Procedurat Standarte te Tenderimit per Kushtet e Financimit nga OSSH sh.a**

Deklarata Rregullatore nder te tjera percakton edhe se procesi i marrjes se kredive afatgjata nga OSSH sh.a eshte objekt i miratimit nga ERE e cila miratoi me vendimin nr.41 date 25.05.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.94, date 25 qershor 2009, Rregullat dhe procedurat e tenderimit per kushtet e financimit. Ne kete Rregullore jane percaktuar kriteret e kualifikimit dhe kushtet e vleresimit per perzgjedhjen e fituesit.

- **Rregullat dhe procedurat standarte per prokurimit te energjise elektrike nga OSSH sh.a**

•

Me vendimin nr.42, date 25.05.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 94, date 25 Qershor 2009, ne reference te Deklarates Rregullatore, ERE miratoi Rregullat dhe Procedurat Standarte te Tenderimit te Energjise Elektrike per OSSH sh.a duke percaktuar procedurat, afatet e shpalljes se tenderit, afatet e marrjes se dokuemntave, aspektet e anulimit te tenderit dhe natyren e dokumentave qe do te dorezohen ne ERE.

- **Marreveshja per pjesemarrje ne treg**

Ne zbatim te percakitimeve te rregulave te tregut duke konsideruar si nje element i rendesishem ne implemtimin e ketyre rregulave, ERE miratoi me Vendimin nr.47 date 04.06.2009 te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.94 date 25

Qershor 2009, Marreveshjen per pjesemarrjen ne treg. Ky dokument rregullon marredheniet midis paleve, duke percaktuar qartesisht detyrimet dhe te drejtat perkatese te pjesemaresve te tregut, natyra e informacionit qe do te dorezojne ne OSTsh.a pjesemarrsit e tregut.

- **Rregullore per procedurat e paraqitjes dhe miratimit te planit te investimeve**

Ne kauder te pergjegjesive te ERE –s ne sektorin e energjise elektirke nje dokuemnt mjaft i rendesishem qe lidhet me percaktimin e cmimeve si dhe me cilesine dhe sigurine e funizimit me energji elektrike eshte Rregullorja per porcedurat e paraqitjes dhe miratimit te Planit te Investime miratuar nga ERE me vendimin nr.62 date 15.09.2009 dhe te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.147, date 22 tetor 2009. Nepermjet kesaj Rregullore percaktohen qarte ceshtjet qe kane te bejne me: Komponentet kryesor qe lidhen me nje plan investimi, paraqitja dhe miratimi i planit te investimeve, parimet mbi bazen e te cileve do te behet miratimit i tij nga ERE, Aksesit i publikut ne procesin e miratimit te planit te investimeve, duke vendosur te drejten e paleve te interesuara per te shprehur komentet e tyre, si dhe per te marre pjese ne seancen degjimore qe ERE zhvillon per kete ceshjte.

Ne vendosjen e nje dispozite te tille kemi pasur parasysh se miratimi i planit te investimit nga ERE, reflektohet ne tarife e cila prek drejtperdrejt konsumtoret tarifore te energjise elektrike.

- **Modeli i Kontrates se Shitblerjes se energjise elektrike ndermejt KESH sh.a dhe Pordhuesve te Vegjel te Energjise.**

Me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, te botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 164, date 3 dhjetor 2009, ERE miratoi Modelin e Marreveshjes se shitjes se energjise elektrike e cila eshte nje kerkese qe buron nga Modeli i Tregut te Energjise Elektrike. Qellimi i kesaj Kontrate eshte te percaktoje detyrimin e Bleresit per te blere dhe detyrimin e Shitesit per te shitur te gjitha energjine e prodhuar nga shitësi prej nje HEC-i te vogel, ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi per kete qëllim.

Duke u nisur nga fakti se investimet ne kete sektor kerkojne nje kohe te gjate veteshlyerjeje (8-10 vjet), kjo kontrate ne zbatim te politikave inkurajuese per zhvillimin e ketij sektori, u vendos te jete nje kontrate afatgjate, duke percaktuar

lenien ne fuqi per nje periudhe 15 vjeçare. Kontrata e miratuar parashikon se palet duhet t'i sigurojne njera - tjetres dokumentacionin e nevojshem, i cili do te evidentojte programet, sasite, levrimet dhe marrjet e energjise elektrike, mbi bazen e te ciles do te kryhet faturimi dhe pagesa qe Bleresi do t'i kryeje Shitesit, si dhe do te

verifikojne mosperputhjet mes flukseve te programuara dhe atyre te realizuara.

4.2. Amendimet ne legjislacionin primar ne sektorin e energjise gjate vitit 2009

- **Ligji nr. 10137 date 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” .**

Ne muajin dhjetor te vitit 2009 nepermjet miratimit te ligjit nr.10137, date 11.05.2009, për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, te botuar ne Fletoren Zyrtare nr.86 /2009 Kuvendi miratoi nder te tjera ndryshimin e nenit 34/1 ne te cilin u shtua pika 2 me permbajten :

Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese, sipas pikës 1 të nenit 34/1, të këtij ligji, përfshihet në kategorinë IV.3, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje miratohen në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre lejeve.

- **Ligji nr. 10196 date 10.12.2009 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”**

Me date 10.12.2009, Kuvendi miratoi disa ndryshime ne ligjin per sektorin e energjise elektrike. Keto ndryshime ishin frut i bashkepunimit ndermjet METE-s dhe Entit Rregullator te Energjise. Keto ndryshime bene nje percaktim me te detajaur te rolit te Entit Rregulator te Energjise ne fushen e certifikimit te energjive te rinovueshme. Ne perputhje me keto ndryshime qe preken nenet 8 dhe 39 te ligjit per sektorin e energjis eeltrike, ERE eshte autoriteti pergjejges per percaktimin e rregullave per kualifikimin e centraleve prodhues, qe perdorin burime te rinovueshme, kategorite e centraleveve, formulat dhe koeficientet llogarites te sasise se energjise elektrike te prodhuar per perfitimin e certifikatave te origjines dhe certifikates se gjelber.

Gjate vitit 2010 mbetet detyre e ERE-s te rishikoje Rregullat per procedurat e certifikimit te burimeve te rinovueshme, me qellim harmonizimin e ketyre te

fundit me vendet e tejra sic kerkohet edhe nga Ligji per sektorin e energjise elektrike dhe ndryshimet me te fundit qe ai pesoi.

4.3. Aktet e Keshillit te Ministrave per Energjine gjate vitit 2009

Gjate vitit 2009 u miratuan aktet e meposhteme te Keshillit te Ministrave qe kane te bejne me sektorin e energjise:

- **Miratimi i ndertimit te burimeve te reja energjitike dhe linjave tregtare te interkoneksionit**

Ne kuader te strategjise kombetare te energjise, per nxitjen e investimeve ne kete sektor, gjate vitit 2009, Keshilli i Minsitrave ka miratuar dhenien e nje numri te madh koncesionesh per realizimin e projekteve ne kuader te ndertimit te burimeve te reja hidroenergjitike. Nje pjese e subjektve qe kane marre koncesione gjate vitit 2009, jane licensuar nga ERE ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike. Nga ana tjetere po gjate vitit 2009 jane dhene nga Keshilli i Minsitrave leje per ndertim dhe shfrytezim te linjes tregtare te interkonjeksionit me rryme te vazhduar Porto Romano/Durres (Shqiperi) –Cassamassima /Bari Itali si dhe leje per shfrytezim te lnjes tregtare me rryme te vazhduar te interkoneksionit Vlore Shqiperi – Brindizi Jug (Itali).

- **Ndryshimet ne Modelin e Tregut te Energjise Elektrike**

Modeli i Tregut i Energjise Elektrike eshte miratuar me VKM nr.338, date 19.03.2008. Gjate vitit 2009 ne reflektim edhe te situates qe lidhej me privatizimin e nje sektori mjaft te rendesishem, ate te shperndajres se energjise elektrike, ky model pesoi disa ndryshime.

Keshilli i Ministrave me Vendimin nr.143 date 11.02.2009, vendosi nje mase tranzitore duke shtuar ne kete model dispoziten 10 me permbajten: Sa kohë që OSSH,sh.a është shoqëri shtetërore, energjia elektrike, që prodhohet nga KESH, sh.a, mbi kërkesën e furnizuesit publik me pakicë, i shitet OSSH, sha-së, për mbulimin e humbjeve, në sasinë që kërkohej prej saj. Çmimi i shitjes do të jetë çmimi i miratuar nga ERE, për furnizuesin publik me pakicë, për vitin, në të cilin realizohet shitja.

Kjo dispozite ne vijim u ndryshua permes vendimit nr.420 date 30.04.2009, duke percaktuar se per energjine qe OSSH sh.a do te bleje per mbulimin e

humbjeve nga KESH sh.a, ERE do të përcaktoj në mungesë të arritjes së marreveshjes midis palëve, çmimin e shitjes së energjisë elektrike kontraktuar prej tyre (OSSH sh.a dhe KESH sh.a), për sa kohë OSSH sh.a do të jetë shoqëri shtetërore.

Nje ndryshim i rendesishem ne Modelin e Tregut u be nepermejt vendimit

te Keshillit te Minsitrave nr.511, date 13.05.2009. Ky vendim ishte ne kuader te propozimit te ndermarre nga ERE e cila evidentoi nevojën per te percaktuar ne Modelin e Tregut nje minimum te lejueshem te disbalancave, devijimeve, per te cilat pjesemarresit e tregut nuk paguajne sanksione. Percaktimi ne Modelin e Tregut te nivelit te lejueshme te disbalancave, (+/- 5%) dhe sanksioneve mbi kete minimum sherben per qendrushmerine e sistemit elektroenergjitik.

4.4. Plotesimi i pyetesorit per energjine ne proceduren e aplikimit te Shqiperise per Vend Kandidat ne BE.

Vemendje te veçante ERE i ka kushtuar plotesimit te pyetesorit te Komisionit Evropian ne reference te angazhimit te ndermare nga qeveria shqiptare ne kuader te zbatimit te Mareveshjes se Stabilizim Associmit. Ne kete drejtim ne kuader te grupit nderinstitucional te punes te ngritur nga Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes, ERE ju ka dhene pergjigje pyetjeve qe kane te bejne me kapitujt 3 dhe 15 te Pyetesorit. Ne kete drejtim ERE ju ka dhene pergjigje kryesisht pyetjeve ne lidhje me:

- Ngritjen dhe funksionimin e nje rregullatori te pavarur, duke evidentuar se duke filluar qe nga viti 1995 kompetencat dhe pergjegjesite e rregullatorit jane te percaktuara me ligj.
- Rregjimin e licensimeve, i cili ka rregullim sipas ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” dhe Ligjit “Per Gazin Natyror”, ne baze te te cilit ERE eshte institucioni per dhenien e licensave ne aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shperndarjes, furnizimit, dhe tregtimit te energjise elektrike.
- Vendorsjes se tarifave, nese tarifat reflektojne kostot, struktura e tarifave te transetimit dhe shperndarjes, ku ne baze te metodologjive te sipercituara, aktualisht ne Shqiperi çmimet e miratuara per periudhat perkatese rregullatore perfaqesojne kostot e sherbimit te aktivitetit te prodhimit, furnizimit me shumice, sherbimit te transmetimit, sherbimit te shperndarjes, sherbimit te furnizimit me pakice.

- Nivelit të arketimeve, ku sipas raportimit të OSSH sh.a rezultoi se për vitin 2009 ai është 76.4%.
- Organizimit dhe infrastrukturës së sektorit të energjisë, i cili në sektorin e

energjisë elektrike është përcaktuar sipas Modelit të Tregut të Energjisë të miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.338 datë 19.03.2008. Në këtë model është përcaktuar skema e tregut shqiptar të energjisë elektrike, pjesëmarrsit dhe roli i tyre në sektor, roli dhe përgjegjësit e rregullatorit..

- Legjislacionit për promovimin e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike, ku sipas Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” nën 8, ERE promovon konkurrencën në sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu sipas nënit 33, çdo kompani e angazhuar në prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, e cila merret me aktivitete të tjera që nuk janë pjesë e sektorit elektorenergjetik, do të sigurojë të dhëna të ndara të kontabilitetit për prodhimin e tyre, shpërndarjen dhe furnizimin me qëllim për të shmangur ndërsubvencionet, aktivitetet që funksionojnë si monopole në sektorin e energjisë.
- Procesi i privatizimit në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror duke evidentuar se aktualisht në sektorin e energjisë elektrike ka përfunduar ndarja e aktiviteteve të prodhimit transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike ligjrisht dhe financiarisht. Në sektorin e energjisë elektrike në vitin 2009 ka përfunduar me sukses procesi i privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a), i cili përveç aktivitetit të shpërndarjes kryen edhe aktivitetin e furnizimit publik me pakicë. Nga ana tjetër procesi i privatizimit ka filluar në vitin 2000 me privatizimin ose dhënien me koncesion të HEC-eve të vegjël me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe vazhdon me sukses me një numër të madh kontratash koncesionare për investime private në sektorin e energjisë elektrike.
- Rregullimi ligjor i Prodhuesve të Pavarur të Energjisë. Në lidhje me këtë pikë, ligji për sektorin e energjisë elektrike përcakton se PPE-të janë prodhues jo publik të lidhur direkt me sistemin e transmetimit dhe se kostot e lidhjes me rrjetin e një prodhuesi të ri të pavarur të energjisë elektrike dhe kostot në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes që lidhen me të perballohen nga prodhuesi, në përputhje me Kodin e Rrjetit. Operatori i Sistemit të ka të drejtën e pronësive mbi këtë lidhje. Gjithashtu në nënin 46

te ketij ligji parashikohet se Furnizuesi Publik me Shumice ka detyrimin te bleje energji elektrike nga gjeneruesit publik, Prodhuesit e Pavarur dhe Prodhuesit e Vegjel te Energjise si dhe tregtaret per nevoja te klienteve tarifore.

5. Mbrojtja e konsumatorit nga efekti monopol ne tregun e energjise elektrike

5.1 Parimet e mbrojtjes se konsumatorit

Per zhvillimin dhe funksionimin e drejte dhe jodiskriminues te tregut te energjise dhe te gazit, eshte vendimtare qe konsumatorët te jene te mire perfaqesuar dhe te drejtat e tyre te mbrohen dhe te percaktohen ne menyren e duhur.

Kuadri rregullator mbi te cilin mbeshtetet e gjithe veprimtaria e ERE-se, i kushton nje rendesi te vecante mbrojtjes se interesave dhe garantimit te te drejtave te atyre pjesemarresve te tregut qe nuk kane mundesine dhe aftesine e duhur per te njohur dhe per te patur aksesin e nevojshem si ne kuadrin ligjor ashtu edhe ne aspektin teknik te funksionimit te tregut, duke u ekspozuar keshtu ndaj shkeljeve te mundshme te te drejtave te tyre nga efekti monopol i tregut te energjise.

Per kete arsye, fuqizimi i rolit aktiv te konsumatoreve ne treg, mireinformimi dhe mbrojtja e interesave te tyre, ne menyre te vecante te konsumatoreve familjare, eshte nje nga sfidat me te rendesishme dhe prioritetet kryesore te ERE-s.

Gjate vitit 2009, aktiviteti i ERE-s ne drejtim te mbrojtjes dhe forcimit te interesave te konsumatoreve, eshte shtrire ne keto drejtime kryesore:

- Sigurimi i transparences dhe konsultimi me palet e interesuara dhe publikun gjate procesit te hartimit te kuadrit rregullator, te rishikimit te tarifave dhe cmimeve te energjise elektrike, te miratimit te licensave si dhe ne procesin vendimtar te ERE;
 - Trajtimi dhe zgjidhja e mosmarreshjeve midis konsumatoreve dhe furnizuesit, si dhe ndermjet te licensuarve;
 - Garantimi i te drejtes se aksesit te paleve te treta ne rrjet;
 - Respektimi i parimeve te njohura rregullatore te moslejimit te ndersubvencionit midis kategorive te ndryshme te konsumatoreve dhe te reflektimit te drejte te kostos per cdo kategori konsumatorësh;
 - Monitorimi dhe kontrolli i cilesise se sherbimit te te licensuarit per konsumatorët e energjise elektrike.
-
- **Sigurimi transparences**

ERE, gjate procedurave te miratimit te kuadrit rregullator, dhenien e licensave per veprimtarite e ushtruara ne sektorin e energjise, miratimin e tarifave te shitjes me pakice te energjise elektrike, si dhe procesin vendimarrës, (mbledhjet e Bordit te Komisionereve), bazuar ne Rregulloren e Praktikës dhe Procedurave zbaton kriterin e transparencës dhe te konsultimit me palet e interesuara dhe me publikun.

Ne kete proces perfshihen publikimet e bera ne median e shkruar te vendimeve te ERE-s per fillimin e procedurave te shqyrtimit te aplikimeve per license, te tarifave, apo te hartimit te rregulloreve apo akteve te tjerave rregullatore, konsultimi me te licensuarit, palet e interesuara si dhe shoqatat qe perfaqesojne konsumatorët. Mendimet dhe verejtjet e tyre, analizohen dhe nepermjet nje procedure transparente iu behet e ditur te interesuarve qendrimi i ERE-se per marrjen parasysh apo jo te tyre.

Ketu do te permendim seancat degjimore publike te organizuara nga Instiucioni jone ne lidhje me shqyrtimin e aplikimit te Kompanive publike per rishikimin e tarifave dhe cmimeve per vitin 2010, seanca te cilat jane konsoliduar tashme si nje institucion qe sigurojne maksimumin e transparencës duke siguruar qe konsumatorët final te kene gjithë informacionin e duhur lidhur me sherbimin dhe koston me te cilen i sigurohet ky sherbim.

Gjithashtu dhe mbledhjet vendimarrëse te Bordit te Komisionereve te ERE-s kane qene kete vit te hapura per publikun, duke marre pjese ne to si perfaqesues nga METE, Kuvendi i Shqiperise, Autoriteti i Konkurencës, perfaqesues te Kompanive publike si dhe subjekteve te interesuar.

- **Garantimi i aksesit te paleve te treta ne rrjet**

Lidhur me garantimin e aksesit te paleve te treta ne rrjetin e shpendarjes, roli i rregullatorit eshte te nxise hapjen e tregut ne menyre qe konsumatorët e energjise te perfitojne sherbime cilesisht me te mira nga konkurrenca ne treg. Hapja e tregut shtyn kompanine te konkuroje per shtim te konsumatoreve duke u ofruar atyre sherbime te shpejta dhe te besueshme.

Ne kete drejtim, mund te permendim disa hapa te rendesishem te ndermarra nga ana e ERE-s per hapjen e tregut dhe garantimin e aksesit te paleve te treta ne rrjet, si psh : vendimi per hapjen e tregut per te gjithë konsumatorët jofamiljare, miratimin e tarifave te vecanta per sherbimin e transmetimit dhe te shperndarjes, miratimi i kontrates per shitjen e energjise ndermjet Prodhuesve te Vegjel dhe Furnizuesit Publik me Shumice, miratimi i kontratave per sherbimin e transmetimit dhe te shperndarjes midis subjekteve te pajisura me leje tregtimi dhe OST dhe OSSH.

5.2 Trajtimi i ankesave te Konsumatoreve

Trajtimi me perkushtim i ankesave te konsumatoreve, mbetet nje nga aspektet me te rendesishme te veprimtarise se ERE-se. Rregullorja e Praktikës dhe Procedurave te ERE-s, parashikon nje procedure transparente ne trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave te konsumatoreve. Kjo procedure tejet transparente si dhe trajtimi ligjor, i paanshem dhe ne perputhje me afatet e percaktuara, ka sjelle nje rritje te numerit te konsumatoreve qe i drejtohen ERE-se per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te tyre me Kompanine e

furnizimit. Kjo rritje deshmon per forcimin e autoritetit te ERE-se, e cila ka ardhur edhe si rezultat i punes per informimin dhe ndergjegjesimin e konsumatoreve per rolin e ERE-se.

Gjate vitit 2009 jane rregjistruar ne ERE 80 ankesa, nga te cilat 50 ankesa nga kliente familjare, 25 nga kliente jofamiljare dhe 5 nga subjekte te licensuara.

Numerin me te madh te ankesave te familjareve, rreth 30, e zene ato per mbifaturim, nga te cilat vetem 5 kane qene te pabazuara; 15 ankesa kane pasur per objekt faturimin aforfe, 7 nga te cilat per vlere te faturuar mbi ate te miratuar nga ERE-ja. Pjesen tjeter e zene ankesat per demtime te matesit dhe moslidhje te kontrates se furnizimit per shkak te detyrimeve te prapambetura te objektit per te cilin kerkohe lidhja e kontrates.

Persa i takon ankesave te subjekteve jofamiljare, do te veconim (8) ato per vonesa ne lidhjet e reja, faturime aforfe, sakesimi i kategorise si konsumator, modifikim te lidhjes ne rrjetin e shperndarjes, etj.

Nje impakt ne sherbimin qe i ofrohet konsumatorit, sidomos pas privatizimit te Kompanise se Shperndarjes, luan edhe zgjidhja e problematikes qe kane subjektet e licensuara qe operojne ne tregun e energjise elektrike si dhe mosmarreveshjet midis tyre. Ketu do te permendim zgjidhjen e mosmarreveshjeve midis KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. per vonesat ne shlyerjen e detyrimeve reciproke. Gjithashtu nga ana e ERE-se jane trajtuar edhe mosmarreveshjet ndermjet HEC-ve te vegjel dhe KESH-it, per mosrakordim te sasise se energjise se prodhuar nga keto HEC-e, 3 ankesa.

Per trajtimin e ketyre ankesave, nga ana e ERE-se jane kryer 50 seanca degjimore teknike me perfaqesues te OSSH dhe subjektit ankimues, verejme se per te njejten ceshtje mund te kete qene e nevojshme te kryhen edhe 2-3 seanca degjimore, pasi palet nuk kane rene dakort. Gjithashtu jane intesifikuar kontrollet dhe verifikimet ne vend te sistemit te matjes te konsumatoreve, rreth 37. Per nje pjese te ankesave, 15, i eshte kerkuar OSSH informacion i detajuar lidhur me ankesat e paraqitura.

Aaliza e problematikave te verejtura tek ankesat e konsumatoreve, sherben per te bere permiresimet e nevojshme te kuadrit rregullator, me qellim ofrimin e sherbimeve me te mira per konsumatoret nga Kompania.

5.3. Trajtimi i proceseve gjyqesore

Enti Rregullator gjate vitit 2009, ka marre pjese ne disa procese gjyqesore, ne te cilat ERE ka qene e thirrur kryesisht ne cilesine e personit te trete. Keto ceshtje

kane pasur per objekt pergjithesisht anulimin e titujve ekzekutiv (kryesisht te faturave te energjise elektrike te OSSH Sh.a.) dhe kundershtrim te gjobave dhe demit ekonomik te vendosura po nga kjo Kompani. Ne keto procese roli i ERE-s ka qene dhenia e shpjegimeve rreth pozicionit te ERE-s ne lidhje me pretendimet e pales paditese.

Vetem ne nje nga proceset gjyqesore, ERE ka qene thirrur ne cilesine e pales se paditur, me objekt shfuqizimin e akteve administrative te ERE-s, lidhur me dy

vendime te ERE-s per transferimin e licensave, per llogari te koncesionarit Essegei Spa.

Per te gjitha proceset gjyqesore te mesiperme, vazhdon gjykimi ne Gjykatën e Shkalles se Pare te rretheve perkatese.

6. Marredheniet me publikun dhe median

6.1 Procedurat e informimit publik

Enti nder detyrat e tij kryesore ka ate te publikimit dhe perhapjes se njohurive dhe informacionit te tij per kushtet e kryerjes se sherbimeve nga Kompanite e licensuara ne sektorin e energjise, me qellim qe te garantoje transparence maksimale, ne funksion te permiresimit te sherbimeve te ofruara perdoruesve te rretit te energjise elektrike si dhe konsumatoreve finale.

Per te arritur kete qellim, ERE ka rritur perpjekjet per informimin e konsumatoreve nepermjet zgjerimit te komunikimit si me operatorët e tregut ashtu edhe me klientët finale. Veprimtaria e komunikimit te brendshem dhe te jashtem, synon te garantoje njohje me te gjere te aktivitetit qe kryen ERE, te imazhit te saj ne aktivitetin e rregullimit.

- **Komunikimi nepermjet ngjarjeve dhe aktiviteteve**

Persa i takon ngjarjeve dhe aktivitet te cilat organizohen nga vete ERE, apo ne te cilat ERE merr pjese, ato konsiderohen vecanerisht efektive, per te bere te njohur akoma me shume funksionet institucionale te ERE, detyrat si dhe veprimet e saj ne drejtim te mbrojtjes se konsumatoreve. Ketu do te permendim raportimet tradicionale te ERE-s – Raportimi Vjetor, Raportimi ne Sekretariatin e Komunitetit te Energjise, Asamblese se MEDREG (Organizata e Rregullatoreve te Mesdheut), ERRA (Organizata e Rregullatoreve te Europes Juglindore), seminare e work shop-e te ndryshme brenda e jashte vendit.

- **Komunikime me pjesetaret e tregut**

Per te permiresuar njohjen e aktivitetit te ERE-s dhe zbatimit te kuadrit rregullator te miratuar prej saj, eshte fuqizuar bashkebisedimi me operatorët e sektorit te energjise, duke organizuar takime periodike me Kompanite Publike si

dhe operatorët e tregut, kryesisht me të licensuarit për prodhimin e HEC-eve të vegjël, lidhur me informimin e tyre me kuadrin rregullator të miratuar nga ERE si dhe njohjen e problematikes që ata ndeshin gjatë operimit në treg.

- **Komunikime të brendshme**

Rendesi të vecantë i është kushtuar edhe komunikimit të brendshëm, nepermjet shpërndarjes së materialeve me karakter informues dhe komunikimeve të ndryshme tematike me investitorët dhe persona të interesuar kryesisht mbi kuadrin rregullator lidhur me burimet e rinovueshme, efikasitetin dhe kursimit të energjisë si dhe mbi modalitetet e paraqitjes së ankesave.

- **Komunikime në Web**

ERE ka zhvilluar komunikimin nepermjet faqes së saj në Web, si nepermjet zgjerimit të përmbajtjes, ashtu edhe nepermjet propozimit të shërbimeve të reja. Faqe e internetit është pasuruar me materiale të reja, si kuadri rregullator i miratuar, vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si dhe rubrika të reja - publikime dhe konsultime për publikun, në të cilën gjatë kësaj periudhe janë shtuar të gjitha materialet e aplikimeve të Kompanive për rishikimin e tarifave, relacionet e ERE-së që kanë shërbyer për marrjen e vendimeve, studimet e kryera (Studimi i Konsumit në familje), etj.

Gjithashtu një informacion të pasur faqja e Web-it ka edhe në gjuhën angleze, në të cilën janë aksesibel të gjitha aktet dhe vendimet e miratuara nga ERE, si dhe informacione të tjera.

6.2. Marrëdhëniet me medianë e shkruarë dhe vizive

Në përgjithësi, ka filluar të ngrihet niveli i komunikimit me medianë e shkruarë dhe vizive, intervistave, si duke realizuar deklaratatë për shtyp, në të cilat është patur kujdes kryerja e komunikimit me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, ashtu edhe duke organizuar takime dhe mbajtur kontakte të vecanta me media e gazetarë që mbulojnë këto sektorë.

Gjithashtu përfaqësues të ERE-s kanë marrë pjesë në emisione të ndryshme televizive për të informuar dhe sqaruar publikun mbi temat të vecanta me interes për konsumatorët. Janë forcuar gjithashtu marrëdhëniet me strukturat e komunikimit me institucionet kryesore të vendit.

7. Marrëdhëniet nderinstitucionale dhe nderkombetare

Për vitin 2009, zhvillimi i marrëdhënieve nderinstitucionale brenda vendit dhe marrëdhëniet nderkombetare multilaterale dhe bilaterale kanë zënë një vend të vecantë në veprimtarinë e ERE-s.

7.1. Marrëdhëniet nderinstitucionale brenda vendit

Enti Rregullator ka vleresuar si mjaft te rendesishem zhvillimin e marredhenieve te tij nderinstitucionale nder te cilat mund te permendim marrdheniet me Kuvendin e Shqiperise, Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes, Autoritetin e Konkurrences, Avokatin e Popullit, si dhe institucione te tjera ne vend.

- ***Marredheniet me Kuvendin e Shqiperise***

Gjate vitit 2009 ERE ka konsoliduar akoma me shume marredheniet me Kuvendin e Shqiperise, ne vecanti me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit.

ERE e ka informuar Kuvendin mbi zhvillimet korente ne sektorin e energjise, ku pervec paraqitjes ne Kuvend te Raportit vjetor, ERE ka paraqitur informacion ne drejtim te ceshtjeve te mprehta qe kane te bejne me Tregun e Energjise, me hartimin e akteve nenligjore, me procesin e post-privatizimin si dhe per cmimet dhe tarifate e energjise elektrike.

Ne 17 Dhjetor 2009, ERE ne nje seance te posacme me Komisionin e Veprimtarise Prodhuese ka informuar ne menyre te hollesishme per situaten elektroenergjetike ne vend si dhe per gjith proceduren e caktimit te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2010, ne perputhje me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.100, date 15.12.2009. Perfaqsesit e ERE-s ju dhane pergjigje te gjitha pyetjeve te deputeteve pjesmarres ne takim.

ERE, dhe gjate vitit 2009 ka vazhduar te ndjeke nje forme bashkepunimi dhe informimi periodik duke pasqyruar hap pas hapi veprimtarine institucionale ne zbatim te vendimit te Byrose se Kuvendit No 29 date 09.02.2008 "Per ngritjen e Sherbimit te Monitorimit te institucioneve qe raportojne dhe informojne Kuvendin". Ne kete kuader Keshilltarja e Kuvendit pergjegjese per kryerjen e ketij sherbimi ka ndjekur nga afer dhe eshte njohur ne menyre te hollesishme me veprimtarine e ERE-s, si dhe ka asistuar ne mbledhje te Bordit te Komisionereve. Persa i perket te ardhmes ERE angazhohet ta vleresoje me seriozitet dhe te kete nje nga perpaesite kryesore bashkepunimin me Kuvendin e Shqiperise.

- ***Marredheniet me METE-n***

Gjate vitit 2009 ERE ka bashkepunuar ngushte me Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (METE) ne drejtim te zgjidhjes se problemeve dhe sfidave me te cilat po perballet sektori i energjise ne Shqiperi.

ERE ka qene pjese aktive e Grupeve nderinstitucionale te Punes per rishikimin e Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te Ligjit te energjive te rinovueshme, ka shprehur mendimet e saj mbi linjat e interkonjeksionit, ka marre pjese ne Komitetin koordinues per HEC-et e vegjel dhe lidhjen e tyre me sistemin energjistik, si dhe ceshtje te tjera qe kane te bejne me tregun e energjise elektrike, me

te licensuarit dhe me te gjitha palet e pjesemarrrese ne sektorin e energjise ne Shqiperi.

ERE ka kontribuar qofte permes propozimeve te dala prej saje apo permes dhenies se opinionit per ndryshimet e propozuara te Modelit te Tregut te miratuara me pas nga Keshilli i Ministrave.

Nje bashkepunim te frytshem ERE ka pasur edhe ne punen e grupit nderinstitucional te punes per plotesimin me cilesi te pergjigjeve te pyetsorit per aplikimin e Shqiperise si vend kandidat ne BE.

- ***Marredheniet me Autoritetin e Konkurrences***

Bazuar ne Memorandumin e Mirekutimit te nenshkruar mes ERE-s dhe Autoritetit te Konkurrences ne date 17.01.2007 eshte bere dhe institucionalizimi i bashkepunimit mes dy institucioneve perkatese qe synon ne mbrojtjen e konkurrences se lire dhe efektive te pjesemarrsesve te tregut te energjise elektrike.

Keshtu gjate vitit 2009, keto dy institucione kane bashkepunuar per shmangien e shkeljes se konkurrences nga operatoret, duke krijuar rregulla konkurruese ne mbrojtje te interesave te konsumatoreve. ERE ka kerkuar rregullisht mendimin e Autoritetit per aktet nenligjore qe lidhen me zhvillimin e tregut te energjise perpara se te miratohen nga ERE, ne procesin e llogaritjes se tarifave dhe cmimeve te energjise elektrike, ne percaktimin e analizes se nivelit te humbjeve etj. ERE i ka dhene Autoritetit te Konkurrences te gjitha informacionet e nevojshme qe administrohen nga ERE, ne punen e Autoritetit, per hetimin ne sektorin e energjise elektrike.

Nga ana e ERE-s shprehet vullneti dhe gadishmeria qe komunikimi, shkembimi i informacionit dhe te dhenave ndermjet te dy institucioneve do te vijojne dhe ne te ardhmen.

- ***Marredheniet me Avokatin e Popullit***

Mbrojtja e konsumatoreve te energjise elektrike eshte detyre e perbashket qe ERE ndan me insitucionin e Avokatit te Popullit. Ne kete kuader, ERE ka mbajtur marredhenie te aferta institucionale me Avokatin e Popullit duke kryer dhe takime te perbashketa ne drejtim te shkembimit te mendimeve dhe dhenies se sqarimeve te nevojshme per cilesine e sherbimeve te furnizmit me energji elektrike te konsumatoreve, si dhe per procesin e vendosjes se tarifave dhe cmimeve te energjise elektrike per vitin 2010.

Nga ana e Avokatit te Popullit eshte pershendetur mjaft here qendrimi i ERE-s ne vendimarrjen e saje, qendrim ky qe ka mbajtur ne konsiderate mbrojtjen e interesave te konsumatoreve shqiptare duke vepruar me paanesi, integritet dhe objektivitet te larte. Te dy keto institucione konvergjojne jo vetem per pagimin e faturave te energjise elektrike nga te gjithe konsumatoret por edhe per forcimin e

veprimtarise se organeve te zbatimit te ligjit, vecanerisht Prokurorise, ne çuarjen para drejtesise pa kompromis te personave pergjegjes qe abuzojne me energjine elektrike.

Keto institucione do te kene nje angazhim te ndersjellte institucional ne mbrojtje te te drejtave te konsumatorit dhe mbajtjen e kontakteve per te gjitha procedurat dhe seancat degjimore qe do te zhvillohen vecanerisht per tarifat e energjise elektrike.

Krahas Institucionit te Avokatit te Popullit, ERE ka pasur mardhenie nderinstitucionale edhe me Zyren per Mbrojtjen e Interesave te Konsumatoreve, duke organizuar takime informuese, pjesmarrje ne seanca degjimore dhe duke spjeguar vendim-marrjet e rendesishme te saje. Eshte me rendesi te theksohet se ne pergjithesi eshte gjetur mirekuptimi ne problemet e trajtuara.

7.2. Marrdheniet nderkombetare multilaterale

Marrdheniet nderkombetare te ERE-s per vitin 2009 kane synuar forcimin e kapaciteteve institucionale, perfaqesimin e vendit tone ne nismat dhe aktivitetet nderkombetare, ne drejtim te rritjes se njohurive dhe eksperiences se stafit tone, ne ndjekje te praktikave te vendeve te BE-se, si dhe ne vleresimin e vendosjes e bashkepunimeve te frytshme ne dobi te sektorit te energjise ne vend. Duke patur ne konsiderate keto qellime, ERE ka vazhduar marrdheniet multilaterale me organizata nderkombetare si ERRA, MEDREG, NARUC, Sekretariati i Vjenes etj. si dhe ka vendosur marrdhenie bilaterale me institucione te tjera Rregullatore si motra, si dhe ka marre pjese ne konferenca dhe aktivite nderkombetare lidhur me energjine.

ERE është anëtare me te drejta te plota ne Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) dhe ndjek takimet e Asamblese se Pergjithshme te Kryetareve te ERRA-s, takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij te Tarifave e Çmimeve, si dhe te Grupit te Punes mbi çeshtjet ligjore. Persa i perket trajnimeve te organizuara nga ERRA, ERE ka marre pjese ne trajnimin per monitorimin e te licensuarve, ne trajnimin mbi ceshtjet e tarifave, ne trajnim per energjite e rinovueshme dhe stafin e ri te rregullatoreve, si dhe ne nje trajnim te vecante qe eshte zhvilluar teresisht per ceshtjet e gazit dhe rregullimin e tij.

ERE eshte anetare e Shoqates se Rregullatoreve te vendeve te Mesdheut per energjine elektrike dhe gazin (MEDREG, e krijuar ne Maj te vitit 2006) dhe ndjek rregullisht takimet e grupeve te punes per energjite e rinovueshme dhe ceshtjet e gazit, si dhe takimet e Asamblese se Pergjithshme te ketij organizmi mesdhetar. Nepermjet ketij organizmi koordinohet puna per njohjen e mundesive dhe potencialeve energjetike te Vendeve te Mesdheut dhe per krijimin e nje klime mirekuptimi dhe bashkepunimi te rregullatoreve te ketyre vendeve per probleme me interes reciprok.

Ne partneritet te ngushte me NARUC (Shoqata e Enteve Rregullatore te SH.B.A-se) dhe me mbeshtetjen financiare te USAID, ERE ka planifikuar gjate

vitit 2009 realizimin e nje aktiviteti partnershipi ne fushen e gazit natyror, prane nje rregullatori me pervoje ne kete fushe ne Sh.B.A. Ky aktivitet do te kryhet ne vitin 2010 duke vleresuar se do te jete nje shkembim i vyer eksperience dhe ndihmese per ERE-ne ne hartimin e akteve nenligjore per rregullimin e sektorit te gazin natyror.

Per vitin 2009 ERE ka marre pjese aktive ne Forumet e Athinës dhe

aktivitetet e Komunitetit te Energjise te organizuara nga Sekretariati i Vjenes ne baze te Traktatit te Komunitetit te Energjise, sic kane qene takimet e rregullta te Grupeve te Punes per ceshtjet e konsumatoreve, te energjise dhe tregut rajonal te energjise, si dhe gazit natyror. Pjesemarrja ne keto aktivite i sherben vendeve te Evropes Juglindore, ku ben pjese edhe vendi yne, per te harmonizuar legjislacionin, praktikat dhe procedurat me synim krijimin e nje tregu rajonal te energjise, transparent, konkurues, jo diskriminues dhe me akses te barabarte per te gjithe pjesmarresit dhe me qellim integrimin ne tregun e BE-se.

Gjithashtu, i dukshem ka qene interesi i ERE-s gjate vitit 2009 mbi eksperiencat energjitike evropiane dhe me gjere ne shkalle boterore nepermjet pjesemarrjes se saj ne aktivite nderkombetare ku mund te permendim Konferencen e Investimeve per energji ne vendet e Evropes Juglindore, Forumet Evropiane per Energjine dhe Gazin, Forumin e KransMontanes, Forumin e Mesdheut per Energjine, Konferencat per tregjet Evropiane dhe Konferencat e organizuara per ceshtjet e gazit ne vendet e rajonit, si dhe ne workshopet e organizuara mbi rolin e rregullatoreve ne ceshtjet e klimes dhe ngrohjes globale. Institucione te rendesishme trajnimi dhe kualifikimi per ERE-n kane qene Shkollat e Rregullimit te Firences dhe Budapestit, ne te cilat u trajnuan komisionere dhe personeli teknik i te gjitha niveleve me pjesmarrje te drejtperdrejte, por edhe nepermjet edukimit ne distance.

7.3. Marredheniet nderkombetare bilaterale

Gjate vitit 2009, ERE ka punuar ne drejtim te bashkepunimit me baza bilaterale realizuar kjo nepermjet marreveshjeve bilaterale ku mund te permendim ate te nenshkruar me Entin Rregullator tItalian, Enteve Rregullatore te Turqise dhe Greqise, si dhe marrdhenie te aferta me shume institucione rregullatore te rajonit e me gjere sic mund te permendim Rregullatorin e Rumanise, Çekise etj; Ne aktivite e perbashketa me keta rregullatore theksi eshte vene ne shkembimin e eksperiencens lidhur me procesin e privatizimit dhe eshte kerkuar mbeshtetje teknike nepermjet organizimit te vizitave studimore dhe kualifikimeve ne drejtim te ngritjes profesionale te stafit te Rregullatorit.

7.4. Tregu rajonal i energjise elektrike

ERE ka bere perpjekje qe ne kuadrin e inisiativave rajonale te kontribuojë per krijimin e nje tregu rajonal transparent dhe konkurues te energjise elektrike si

dhe per integrimin e vendit tone edhe ne tregun evropian. ERE ne veprimtarine e saj gjate vitit 2009, ka vleresuar dhe marre ne konsiderate Direktivat dhe Rekomandimet e BE-se dhe te Traktatit te Komunitetit te Energjise per energjine elektrike dhe gazin natyror, duke marre pjese ne grupet e punes dhe aktivitetet rajonale e nderkombetare per tregun e energjise ne menyre te vecante ato te Sekretariati te Vjenes si nje organ i krijuar ne kuadrin e Traktatit te Komunitetit te energjise.

Per ERE-n mbetet prioritet dhe ne periudhen ne vijim pjesemarrja ne aktivite qe do te zhvillohen ne kuadrin e implementimit te ketij Traktati per krijimin dhe konsolidimin e tregut rajonal e me gjere.

8. Burimet njerezore te ERE-s

Burimet njerezore te ERE-s jane te organizuara ne tre njesi themelore :

- a- Bordi i Komisionereve
- b- Stafi i ekspertizes teknike
- c- Stafi mbeshtetes.

8.1.Struktura organizative dhe menyra e funksionimit te ERE-s

4.8.1 Bordi i Komisionereve:

Ne strukturen e Bordit te Komisionereve bejne pjese:

- 1- Kryetari i Bordit.
- 2- Kater antare te Bordit.
- 3- Keshilltari i Bordit.
- 4- Sekretaria e Bordit.

Gjithesej 7 punonjes.

Ne perputhje me ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" te ndryshuar, Kryetari dhe kater antaret e Bordit zgjidhen nga Kuvendi i Shqiperise dhe perfaqesojne strukturen vendim-marrese te institucionit. Gjate vitit 2008 Bordi i Komisionereve mori 144 vendime

Ne baze te po ketij ligji, Kryetari i Bordit eshte njekohesisht edhe administratori egzekutiv i ERE-s

4.8.2 Stafi i Ekspertizes Teknike:

Eshte i organizuar ne tre drejtori dhe nje sektor:

- 1. Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave te Energjise Elektrike, me 5 punonjes.
- 2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit, me 7 punonjes.
- 3. Drejtoria e Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, me 5 punonjes.
- 4. Sektori i mardhenieve me jashte me 1 punonjes

Gjithesej 18 punonjes.

4.8.3 Stafi Mbeshtetes:

Eshte i organizuar ne Drejtorine e Administrate-Finances dhe Burimeve Njerezore me gjithesej 7 punonjes.

1. Drejtor, 1 Arketar-arkivist-magaznier, 1 Specialist IT, 3 shofere dhe 1 Sanitare.

Struktura ekzistues e ERE-s, sipas Vendimit te Kuvendit te Shqiperise Nr 181, date 5.5.2008 , perbehet nga gjithesej 32 punonjes.

Ne Aneksin "A1", bashkalidhur, paraqitet organograma dhe numri i punonjesve te struktures egzistuese te ERE-s.

Mosha mesatare e puonjesve ne vitin 2009 ishte 39.4 vjet.

Me perjashtim te 4 punonjesve te sherbimit, i tere personeli prej 28 punonjesish, eshte me arsim te larte. Te gjithe punonjesit zoterojne gjuhen angleze dhe 30% e tyre zoterojne te pakten edhe nje gjuhe tjeter. 21.4% e punonjesve jane me grade shkencore (3 doktore shkencash dhe 3 me graden master). Gjate vitit 2009 vazhdojne studimet pa shkeputje nga puna edhe 3 kandidat per "Master ne Ekonomi"

Nga 28 punonjes administrativo – teknik, 17 prej tyre ose, 60.7% jane femra. Ne pozicionin vendim-marres, femrat zen 20% te vendim-maresve, ndersa ne pozicionet drejtuese ato zene 53.8%, te personelit drejtues. 5 nga punonjesit tane bejne pjese ne jeten akademike universitare si pedagogje te jashtem.

I tere personeli vendim-marres i eshte nenshtruar trajnimeve ne shkollat e specializuara evropiane te rregullimit ne fushen e energjise. Te njejtat parime jane respektuar edhe per personelin drejtues dhe punonjesit e tjere, duke ndjekur te njejtat shkolla, por me programe per nivele te ndryshem qe nga fillestaret dhe deri te personeli me pervojete.

Financimet per kualifikimin dhe trajnimin e personelit ne rreth 80% te shumes, jane mbuluar nga buxheti i ERE-s, kurse pjesa tjeter eshte sponsorizuar nga shoqatat evropiane dhe amerikane te rregullatoreve si ERRRA, NARUK, MEDREG dhe rregullatore te tjere, me te cilet kemi marredhenie bashkepunimi.

E tere baza logjistike e ERE-s eshte e ndertuara sipas koncepteve dhe teknologjise bashkekohore, po keshtu edhe mjediset e punes jane te pajisura dhe te ndertuara ne menyre qe te krijojne kushte optimale per realizimin e detyrave nga cdo punonjes.

4.9 Trajtimi i Burimeve Njerezore te ERE-s

Edhe per vitin 2009 persa i takon fushes se Burimeve Njerezore eshte zbatuar me perpikmeri Ligji nr.9367 date 07.04.2005" Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike" dhe Ligjit nr.9049, date 10.04.2003" Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publik".

Jane plotesuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga te 9 zyrtaret (qe mbartin kete detyrim), brenda afateve kohore dhe nuk kemi asnje shkelje per sa i takon afateve kohore te zbatimit te ligjit. Gjithashtu kemi marre pjese rregullisht ne trajnimet e organizuar nga ILDKP.

Ne muajin shkurt u krye nje kontroll nga inspektoret e ILDKP, nga ana e te cileve nuk u kostatua asnje shkelje ligjore.

Ne zbatim te Vendimit nr.181, date 05.05.2008 te Kuvendit te Shqiperise per miratimin e struktures dhe organikes eshte zbatuar me perpikmeri Ligji

nr.9584 date 11.07.2006, "Per pagat shperblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe te institucioneve te tjera te pavarura te krijuara me ligj." si dhe Vendimi nr.901, date 19.12.2007 i ndryshuar me vendimin nr.1001, date 2.7.2008" Per miratimin e struktures dhe te niveleve te pagave te nepunesve civil/nepunesve te kabineteve dhe punonjesve mbeshtetes ne administraten e disa institucioneve te pavarura ".

Ne vijim te Ligjit nr.9072, date 22.5.2003 " Per Sektorin e Energjise" i ndryshuar, per perzgjedhjen, emerimin dhe promovimin ne detyre te personelit eshte zbatuar ligji nr.8549, date 11.11.1999 i "Statusit te nepunesit civil"

Ne zbatim te ligjit nr.10 160, date 15.10.2009 "Per rregullimin e sherbimit te transportit per funksionaret publik dhe nepunesit civil, ERE me urdher te brendshem zbatoi ligjin i cili hyri ne fuqi me 19.11.2009, si dhe formularin e autorizimit per levizjen e punonjesve te institucionit.

4.10 Administrimi i burimeve financiare te ERE-s

Ne fushen e administrimit dhe finances jane zbatuar me korektesi legjislacionet perkatese per administrimin e financave te ERE-s, te tille si ligji nr.9072 date 02.05.2003 " Per sektorin e energjise elektrike" me ndryshimet perkatese, ligji nr.9643, date 20.11.2006 per " Prokurimet Publike" te ndryshuar, Ligji nr.9228, date 29.4.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe te tjera legjislacione.

Jane zbatuar te gjitha afatet kohore ne lidhje me dorzimin e realizimin e rregjistrimit te prokurimeve te fondeve publike, ne perputhje me ligjin e prokurimeve duke i asistuar te gjitha procedurat perkatese edhe asistence juridike

